



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.59

21 maj

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Akt normativ nr.1, datë 5.5.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar 2227
Dekret nr.6533 datë 6.5.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2229
Vendim i GJK nr.16, datë 19.4.2010	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.88, datë 21.02.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 2230
Vendim i GJK nr.18, datë 23.4.2010	Me objekt shfuqizimin e pikës 5 të nenit 289 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, si e papajtueshme me Kushtetutën 2234
Vendim i GJK nr.19, datë 28.4.2010	Me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Sokol Sadushi..... 2241
Vendim i GJK nr.20, datë 28.4.2010	Me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Fehmi Abdiu. 2242
Vendim i GJK nr.21, datë 29.4.2010	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 14, datë 3.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ... 2243
Vendim i GJK nr.22, datë 5.5.2010	Me objekt 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës për të ushtruar kontroll mbi njësinë e qeverisjes vendore (Bashkia Tiranë), nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. 2. Shfuqizimi i vendimit nr. 249, datë 24.04.2009 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor”.3. Pezullimi i zbatimit të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 249, datë 24.04.2009 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor” 2251

AKT NORMATIV
Nr.1, datë 5.5.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9663, DATË 18.12.2006 “PËR KONCESIONET”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

1.Në pikën 5, emërtimi “...Agjencia e Koncesionit...” zëvendësohet me “...Agjencia e Prokurimit Publik...”.

2.Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14.Agjencia e Prokurimit Publik” është institucioni i ngritur sipas ligjit nr.9643,datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.”.

3.Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. “Komisioni i Prokurimit Publik” është institucioni i ngritur sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave koncesionare

1.Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave koncesionare bëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik.

2.Në ushtrim të mbikëqyrjes së procedurave të koncesioneve, Agjencia e Prokurimit Publik ka këto kompetenca:

a) U kërkon autoriteteve kontraktuese raportime periodike, një herë në 6 muaj, për gjendjen e koncesioneve;

b) Verifikon zbatimin e procedurave koncesionare, në mënyrë periodike, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së koncesionit, në përputhje me këtë ligj e aktet e tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve koncesionare të gjithë informacionin e nevojshëm;

c) Propozon, në përfundim të verifikimeve sipas shkronjës “b” të kësaj pike, masa disiplinore dhe vendos gjoba, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji;

ç) Shpall përjashtimin nga procedurat koncesionare të ofertuesve, të cilët, gjatë një procedure koncesionare, kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë, në bazë të propozimit të autoritetit kontraktues ose në rastin kur i konstaton këto shkelje në përfundim të verifikimit të parashikuar në shkronjën “b” të kësaj pike, dhe kur është rasti, bën kallëzim penal;

d) Mban dhe administron regjistrin e koncesioneve, si dhe dokumentacionin origjinal që dërgohet nga autoritetet kontraktuese brenda 3 (tre) muajve nga data e miratimit të kontratës së koncesionit;

dh) I paraqet Këshillit të Ministrave rekomandime të përgjithshme për gjendjen dhe kuadrin ligjor të koncesioneve.”.

Neni 3

Në nenin 7, emërtimi “...Agjencia e Koncesionit...” zëvendësohet me “...Agjencia e Prokurimit Publik...”.

Neni 4

Neni 24/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 24/1

Organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve

1.Shqyrtimi administrativ i ankesave të ofertuesve ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimmarrjes për përjashtim nga procedurat koncesionare, sipas shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 5/1 të këtij ligji, bëhet nga Komisioni i Prokurimit Publik.

2.Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare.

3.Rregulla të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura miratohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

1.Në të gjithë nenin emërtimi “...Agjencia e Koncesionit...” zëvendësohet me “...Komisioni i Prokurimit Publik...”.

2.Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.Me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim për pezullimin ose jo të procedurave të koncesionit, si dhe për fillimin e procedurave të hetimit administrativ dhe brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike njofton autoritetin kontraktues.”.

3.Pika 9 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenet 25/1 e 25/2, emërtimi “...Agjencia e Koncesionit...” zëvendësohet me “...Komisioni i Prokurimit Publik...”.

Neni 7

Në nenin 25/3, fjala “...agjenci...” zëvendësohet me emërtimin “...Agjencia e Prokurimit Publik...”.

Neni 8

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik ankuesi ka të drejtë që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni, të bëjë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën kompetente.”.

2.Paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 26/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.Në pikën 1, fjalët "...titullari i Agjencisë së Koncesioneve..." zëvendësohen me "...titullari i Agjencisë së Prokurimit Publik...".

2.Në pikën 2, fjalët "...titullari i agjencisë..." zëvendësohen me "Agjencia e Prokurimit Publik ose Komisioni i Prokurimit Publik...".

Neni 10

Dispozitë tranzitore

1.Pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, ankesat ndaj procedurave të koncesionit bëhen në Komisionin e Prokurimit Publik.

2.Ankesat e paraqitura pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, para hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, shqyrtohen nga Komisioni i Prokurimit Publik, në gjendjen në të cilën ato ndodhen. Afati për shqyrtimin e tyre fillon nga data e dorëzimit nga Agjencia e Prokurimit Publik te Komisioni i Prokurimit Publik.

3.Shqyrtimi i ankesave ndaj procedurave të koncesionit nga Komisioni i Prokurimit Publik do të fillojë pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Neni 11

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DEKRET

Nr.6533, datë 6.5.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", ndryshuar me ligjin nr.8442, datë 21.1.1999 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare",

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesën e tij:

Ferat Riza Istrefi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.16, datë 19.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 4.06.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10/4 Akti që i përket:

KËRKUES: GËZIM HYSI, përfaqësuar nga av. Sokol Puto, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr.88, datë 21.02.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vitore Tusha; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.970, datë 11.10.2005, ka deklaruar të pafajshëm shtetasin Gëzim Hysi për kryerjen e veprës penale të “mashttrimit”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, dhe e ka deklaruar atë fajtor duke e dënuar me 200 000 lekë gjobë për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.360, datë 21.04.2006, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përse i përket deklaramit fajtor për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit” dhe ndryshimin e këtij vendimi përse i përket veprës penale të “mashttrimit”, duke e dënuar kërkuesin përfundimisht me 6 muaj burgim.

Rekursin e kërkuesit, Kolegji seleksionues i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.akti 1175, datë 1.12.2006, e ka vlerësuar në përputhje me shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe e ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.9678, datë 13.01.2007 “Për dhënie amnistie”, i cili hyri në fuqi para se të shqyrtohej çështja penale në seancë gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.88, datë 21.02.2007, vendosi pushimin e çështjes për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit “Për dhënie amnistie”.

Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese pretendon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.88, datë 21.02.2007, ka shkelur të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor duke argumentuar se:

- është cenuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, sepse Kolegji Penal duke zbatuar ligjin e amnistisë në çështjen objekt kundërshtimi i) nuk ka analizuar shkaqet e parashtruara në rekurs lidhur me pretendimet për pafajësinë ndaj akuzave penale të ngritura kundër tij, ndonëse kolegji seleksionues e kishte kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke e vlerësuar në përputhje me kërkesat e nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale; ii) nuk është shprehur rreth bazueshmërisë ose jo në ligj të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.360, datë 21.04.2006, gjë që vjen në kundërshtim me nenet 441 dhe 442 të Kodit të Procedurës Penale;

- është cenuar e drejta e mbrojtjes, pasi procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në prani të prokurorit dhe në mungesë të mbrojtësit të të gjykuarit, ndonëse mbrojtësi ka paraqitur një raport mjekësor për pamundësi pjesëmarrjeje në seancën gjyqësore.

II

Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të çdo individit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë vështrim, Gjykata mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit që, në parim, u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ, gjë që përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.06.2009*).

2. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka trajtuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo e drejtë e individit përbën garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 3.06.2009*).

3. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.07. 2006*).

4. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs me objekt prishjen e vendimit nr.360, datë 21.04.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendim që duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e deklaronte kërkuesin fajtor edhe për kryerjen e veprës penale të mashtrimit dhe, në bazë të nenit 143/1 të Kodit Penal, e dënonte atë me 6 muaj burgim.

Nga dosja gjyqësore rezulton se Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë, më datë 1.12.2006, ka vendosur kalimin e çështjes penale për shqyrtim në seancë gjyqësore duke arsyetuar se rekursi i paraqitur nga i gjykuari përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 21.02.2007, në prani të prokurorit e të të gjykuarit dhe në mungesë të mbrojtësit të tij. Gjatë gjykimit, kryesuesi i seancës i ka dhënë fjalën prokurorit, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9678, datë 13.01.2007 "Për dhënie amnistie". Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ndodhet para

rasteve të parashikuara nga neni 387/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe ka arsyetuar se nuk mund ta gjykojë çështjen (për shkaqet e ngritura në rekurs) dhe, për rrjedhojë, ka vendosur “Pushimin e çështjes në Gjykatën e Lartë”.

5. Referuar konstatimeve të mësipërme dhe përmbajtjes së normave procedurale penale që përcaktojnë kufijtë dhe rregullat e shqyrtimit gjyqësor të rekursit të ushtruar kundër vendimeve të formës së prerë, Gjykata, vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar kërkesën paraprake të të gjykuarit për shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të mungesës së avokatit të tij; nuk është shprehur mbi shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi (rekursuesi), të cilat kanë të bëjnë me pretendimin e tij për pafajësi (nenet 432 dhe 434 të Kodit të Procedurës Penale); dhe nuk është shprehur për bazueshmërinë në ligj apo jo të vendimit të gjykatës së apelit, i cili ka qenë objekt i kundërshtimit të rekursit (nenet 441 dhe 442 të Kodit të Procedurës Penale).

6. Gjykata, në funksion të kontrollit të respektimit të standardit për akses në gjykim, vlerëson të shprehet paraprakisht për kuptimin kushtetues e ligjor të amnistisë, si dhe për pasojat që ajo sjell ndaj procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Amnistia, sipas nenit 81 pika 2 germa “ë” të Kushtetutës së Shqipërisë, miratohet me ligj nga Kuvendi me shumicën e tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij. Ajo përbën një masë të përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe, apo dënimeve përkatëse. Në trajtimin doktrinar penal dhe jurisprudencial të amnistisë njihen amnistia e veprës penale që vepron para dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit me pasojë shuarjen e veprës penale të kryer dhe amnistia e dënimit, e cila ndërhyr pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e dënimit, dhe të dënimeve aksesore edhe pse mbeten efektet e tjera penale. Ndryshimi midis tyre qëndron në faktin se amnistia e veprës penale sjell si pasojë mosfillimin ose pushimin e ndjekjes penale përpara se të jetë dhënë një vendim përfundimtar dënimi (i ekzekutueshëm), ndërsa amnistia e dënimit sjell efekte pas dhënies së vendimit të ekzekutueshëm.

Në nenin 71 të Kodit Penal përcaktohet se: “*Me aktin e amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë. Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe*”. Nga përmbajtja e kësaj norme rezulton se akti i amnistisë parashikon disa organe të cilat, me hyrjen në fuqi të këtij akti (ligji për dhënie amnistie), marrin kompetencë për të përjashtuar nga ndjekja penale (*amnistia e veprës penale*), nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose për të bërë zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë (*amnistia e dënimit*). Kështu, Prokuroria, që në kuptim të nenit 148/1 të Kushtetutës është organi që ushtron ndjekjen penale dhe gjykata, që në kuptim të nenit 42 dhe 135 të Kushtetutës është organi kompetent që gjykon akuzat e ngritura ndaj individëve për vepra penale, me hyrjen në fuqi të ligjit për amnistinë, autorizohen të përjashtojnë nga ndjekja penale vepra penale të kryera sipas parashikimeve të këtij ligji. Përsa i përket përjashtimit nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose zëvendësimit të tij, organet kompetente janë ato të parashikuara nga ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” (i ndryshuar).

Kodi i Procedurës Penale në disa norma të tij parashikon efektet ligjore që sjell amnistia ndaj procedimit penal dhe ndjekjes penale. Kështu, sipas nenit 290/dh: “*Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur është dhënë amnistia*”; ndërsa neni 387/1 parashikon se: “*Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkaku*”. Neni 428/1, shkronja “c” parashikon se: “*Gjykata e Apelit vendos prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin apo vazhdimin e procedimit*”; ndërsa sipas nenit 442: “*1. Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur: a) vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk duhet të fillonte e të vazhdonte. 2. Në rastet e parashikuara nga shkronja “a” Gjykata vendos pushimin e çështjes*”.

Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se amnistia e veprës penale gjën zbatim në të gjitha fazat procedurale të procesit penal, me pasojë pushimin e çështjes për ato vepra penale për të cilat ndjekja penale nuk duhet të fillojë ose të vazhdojë. Kështu, në rastet kur gjykata e shkallës së parë zbaton amnistinë e veprës penale, ajo ka detyrimin të deklarojë pushimin e çështjes. Nëse amnistia e veprës

penale zbatohet në procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, këto të fundit duhet të prishin vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta dhe të pushojnë çështjen penale.

Nga ana tjetër, amnistia e dënimit gjen zbatim vetëm pasi vendimi penal bëhet i ekzekutueshëm sipas rregullave të parashikuara në nenet 417, 420/c dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale, duke e përjashtuar të gjykuarin, sipas rastit, nga vuajtja tërësisht ose pjesërisht e dënimit ose zëvendëson dënimin me një lloj dënimi më të butë.

7. Në çështjen në shqyrtim Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në zbatim të ligjit “Për dhënie amnistie”, ka arsyetuar se i gjykuari quhet i dënuar (neni 4), se ai përfiton nga amnistia si rezultat i dënimit përfundimtar me 6 muaj burgim (neni 1) dhe se vepra penale për të cilën është dënuar nuk përfshihet në ato vepra për të cilat amnistia e dënimit nuk zbatohet (neni 3). Në interpretim të këtyre fakteve dhe të ligjit procedural penal, Kolegji Penal ka arritur në konkluzionin se gjykimi nuk mund të vazhdojë për shkak të efektit që sjell ligji për amnistinë në këtë çështje dhe, për pasojë, në zbatim neneve 387/1 dhe 442/1-a të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur “Pushimin e çështjes në Gjykatën e Lartë”.

Gjykata vlerëson se Kolegji Penal ka zbatuar gabim nenin 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo normë zbatohet në rastin e amnistisë të veprës penale dhe jo në atë të amnistisë së dënimit me të cilën kanë të bëjnë faktet e pranuar në vendim. Edhe në rast se Kolegji Penal do të pranonte fakte që kishin të bënin me amnistinë e veprës penale, dhe si rrjedhim lejonin zbatimin e nenit 387/1 të Kodit të Procedurës Penale atëherë, në zbatim të neneve 441, germa “c”, 442, pika 1, germa “a” dhe, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji duhej të vendoste prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e çështjes.

8. Zbatimi i normës jo në kontekstin e fakteve të pranuar ka kufizuar të drejtën e kërkuarit për gjykim pasi, në këtë rast, dhënia e vendimit të pushimit të çështjes nuk është në përputhje me detyrimin që ka Kolegji Penal për të dhënë një përgjigje përfundimtare lidhur me pretendimet e ngritura në rekurs. Kolegji Penal duhej të respektonte të gjitha standardet e procesit të rregullt në gjykimin e çështjes, pasi amnistia e dënimit nuk kufizon të drejtën e të gjykuarit për t’u gjykuar në përputhje me rregullat që parashikon Kodit të Procedurës Penale. për gjykimin në Gjykatën e Lartë. Pushimi i çështjes në Kolegjin Penal, pa u shprehur mbi vendimin e Gjykatës së Apelit, nuk ka sjellë asnjë pasojë mbi këtë vendim e për rrjedhje, kërkuari (i gjykuari) quhet ende i dënuar dhe i vetmi efekt i ardhur është përjashtimi nga vuajtja e dënimit. Gjykata thekson se interesi i të gjykuarit në një proces penal nuk është vetëm marrja e çfarëdo vendimi që e shmang atë nga vuajtja e një dënimi penal, por edhe zhvillimi i një gjykimi që i lejon atij mundësinë për të debatuar sipas parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, duke pasur si qëllim njohjen e pafajësisë për të rivendosur integritetin, nderin dhe reputacionin.

Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal duhej të kishte shqyrtuar në seancë gjyqësore pretendimet e kërkuarit, pra të zbatonte të drejtën mbi faktet e konstatuara e të vlerësuara në mënyrë të pavarur nga gjykata e apelit dhe të vendoste në përputhje me kompetencat e tij në një nga mënyrat e parashikuara në nenin 441 të Kodit të Procedurës Penale.

9. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se zbatimi i gabuar i normave të Kodit të Procedurës Penale mbi kufijtë dhe rregullat e shqyrtimit gjyqësor dhe ato të marrjes së vendimit, ka sjellë mosgjykimin e thelbit të pretendimeve të kërkuarit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke i mohuar kështu shtetasit Gëzim Hysi të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, si element thelbësor i së drejtës për proces të rregullt ligjor.

III

Në lidhje me pretendimin se është cenuar e drejta e mbrojtjes e për rrjedhje, barazia e armëve.

Kërkuari ka pretenduar se duke e gjykuar çështjen në mungesë të mbrojtësit të të pandehurit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur nenet 31, 33 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nenin 6/1 të KEDNJ, të cilat garantojnë të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të garantimit të “barazisë së armëve”.

Duke pasur parasysh argumentimin e mësipërm, sipas të cilit kërkuari i është mohuar e drejta e aksesit për gjykim në Gjykatën e Lartë që përfshin mohimin e së drejtës për t’iu drejtuar

gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizën e hollësishme të pretendimit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, pasi mohimi i të drejtës së aksesit në gjykim ka sjellë si pasojë pengimin e realizimit të së drejtës së mbrojtjes së kërkuesit, duke e lënë pa efekte këtë garanci mbrojtëse.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese, për shkak se kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “a” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.88, datë 21.02.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

-Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Admir Thanza, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar).

VENDIM

Nr.18, datë 23.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, më datë 26.11.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.26/15 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

SUBJEKTE TË INTERESUARA :

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga znj.Marsida Xhaferllari.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, përfaqësuar nga z.Endri Pema.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, i pikës 5 të nenit 289 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 134/1, d,145/2 të Kushtetutës, nenet 6 e 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe nenet 68, 69, 70 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vladimir Kristo; shqyrtoi pretendimet e kërkuesit; pretendimet e subjekteve të interesuara, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), Këshilli i Ministrave (KM) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Shtetasit M.Gj dhe B.B, në datën 14.12.2003, nëpërmjet pikës doganore të Tushemishtit, kanë importuar nga Republika e Maqedonisë një sasi malli të padeklaruar në autoritetet doganore të kësaj pike.

Në datë 16.10.2008, pas verifikimeve të kryera, Dega e Doganës Pogradec ka nxjerrë vendimin nr. 55, sipas të cilit shtetasit M.Gj dhe B.B, bazuar në nenet, 102, 217, 228, 256/4, 281/1, b të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë janë detyruar të paguajnë shumën prej 96 370 lekë, si detyrim doganor i munguar dhe janë dënuar me gjobë në masën 289 110 lekë (sa trefishi i detyrimit doganor), duke çuar detyrimin e përgjithshëm ndaj Degës së Doganës Pogradec në masën 385 480 lekë.

Sipas akteve rezulton se shtetasit kanë marrë njoftim për vendimin e sipërpërmendur në datën 04.11.2008.

Në datën 5.11.2008, shtetasit e lartpërmendur kanë ankimuar vendimin nr.55, datë 16.10.2008 të Degës së Doganës Pogradec te Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Ky i fundit, me shkresën nr.prot 13441/1, datë 26.11.2008, e ka kthyer ankimin pa veprim pasi nuk përmbushte kushtin e përcaktuar në nenin 289/3 të Kodit Doganor, sipas të cilit shtetasi për të pasur të drejtën e ankimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave duhet të shlyente fillimisht detyrimin doganor të munguar, si dhe 40% të masës së gjobës së vendosur nga autoritetet doganore.

Në datën 5.11.2008 shtetasit M.Gj dhe B.Bazelli kanë depozituar në favor të Degës së Doganës Pogradec gjithë shumën e detyrimit doganor të munguar, si edhe 40% të vlerës së gjobës së vendosur nga autoritetet doganore, në shumën prej 212 014 lekë.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave pas depozitimit të shumës së lartpërmendur, mori në shqyrtim ankimin dhe nëpërmjet shkresës nr. Prot 13441/5, datë 19.01.2009 njoftoi shtetasit e lartpërmendur se kishte vendosur të linte në fuqi vendimin e Degës së Doganës Pogradec.

Në datën 6.04.2009 shtetasit M.Gj dhe B.B i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me kërkesëpadinë me objekt: “Konstatim i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.55, datë 16.10.2008 të Degës së Doganës Qafë-Thanë Pogradec, si dhe shfuqizimin e tij duke rregulluar pasojat”.

Gjatë gjykimit, pala e paditur, Dega e Doganës Pogradec, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për arsye se paditësit nuk kishin plotësuar kushtin e përcaktuar në nenin 289/5 të Kodit Doganor, sipas të cilit, për të pasur akses në gjykatë ndaj një mase administrative të autoriteteve doganore, duhet të shlyenin plotësisht vlerën e mbetur prej 60 % të gjobës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në datë 22.06.2009 vendosi pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së pikës 5 të nenit 289 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet: “Nëse ankesa nuk pranohet, apeluesi duhet të paguajë pjesën që mbetet prej 60 për qind të gjobës, dhe mund të ankohet kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm pranë autoriteteve gjyqësore brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës.”

II

1. Pretendimet e kërkuessit

Gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, kërkesën e tij për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/5 të Kodit Doganor, e ka mbështetur në argumentet e mëposhtme:

-Duke pasur parasysh se e drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë themelore kushtetuese, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut (më poshtë KEDNJ) dhe se e drejta e aksesit është një përbërës thelbësor i kësaj të drejte, Kuvendi, gjatë miratimit të ligjit, nuk ka marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës, pasi detyrimi për të paguar trefishin e detyrimit doganor, i vendosur në formën e sanksionit administrativ, është i lartë dhe aspak i arsyeshëm.

-Shtetasit, për të përfituar të drejtën e aksesit në gjykatë, vihen në pozitë mjaft të vështirë financiare si pasojë e parapagimit të detyrimit doganor të munguar dhe sanksionit administrativ, pozitë që mund të shkojë deri në falimentim.

-Parashikimi i një procedure ankimi me pasoja kaq të rënda financiare mund të shërbejë si faktor frenues për t'iu drejtuar gjykatës, duke e kthyer ankimin gjyqësor në një mjet mbrojtës jo efektiv.

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 42/2) dhe KEDNJ (nenet 6 dhe 13) njohin dhe garantojnë të drejtën e aksesit në gjykatë, qoftë si element i procesit të rregullt ligjor, qoftë si e drejtë për një ankim efektiv.

-Në kundërshtim me aktet e sipërpërmendura, të cilat nga pikëpamja hierarkike qëndrojnë më lart edhe se ligjet e miratuara me shumicë të cilësuar nga Kuvendi, pika 5 e nenit 289 të Kodit Doganor jo vetëm që kufizon në mënyrë jo proporcionale të drejtën e aksesit në gjykatë të individëve, por cenon dhe vetë thelbin e kësaj të drejte, duke shkelur kështu nenin 17 të Kushtetutës.

-Kufizimi që i bëhet të drejtës për gjyq nga paragrafi 5 i nenit 289 të Kodit Doganor tejkalon haptazi kufizimet e vendosura nga nenet 6 dhe 13 të KEDNJ, të interpretuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

2. Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kërkuar nga Gjykata Kushtetuese rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar:

A. Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë

Gjyqtari, në kërkesën e tij për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/5 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, nga pikëpamja formalo-juridike, nuk ka paraqitur asnjë argument lidhur me pamundësinë objektive për t' i dhënë zgjidhje çështjes konkrete, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mungesa e këtyre argumenteve bën që të mos ekzistojë ajo lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitës së prezumuar si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, lidhje kjo e konsideruar si kusht i domosdoshëm për të ushtruar kontrollin incidental nga vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Dispozita e cilësuar nga ana e gjyqtarit të vetëm *prima facie* si antikushtetuese nuk është kundërshtuar nga asnjë nga palët në proces.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka pranuar pretendimin e paditësve në lidhje me pamundësinë objektive për të paguar detyrimet doganore pa kryer asnjë lloj verifikimi në lidhje me këtë pamundësi, duke tejkalluar kompetencat e veta dhe duke u barazuar me subjektet të cilat, në përputhje me nenin 134 të Kushtetutës, kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll kushtetues abstrakt të normave ligjore.

Edhe pse gjyqtari i vetëm nuk ka kufizime kohore për të ushtruar kontrollin incidental, në rastin konkret, prej këtij të fundit, është kontestuar një normë për zbatimin e së cilës ekziston një praktikë gjyqësore e konsoliduar në kohë, praktikë në të cilën përfshihen edhe qëndrime konstante të Gjykatës së Lartë.

Vjelja e detyrimeve doganore dhe lufta ndaj fenomenit të kontrabandës përbëjnë interesa të rëndësishëm publikë dhe si të tillë justifikojnë kufizime të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

Në rastin e nenit 289/5 të Kodit Doganor kemi të bëjmë me një kufizim plotësisht të proporcionuar me gjendjen që e ka krijuar, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

E drejta për akses është e pakufizuar në momentin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe, për këtë arsye, nuk jemi para një kufizimi real të aksesit në gjykatë.

B. Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave

Lidhur me legjitimitimin, gjyqtari i vetëm, duke pezulluar gjykimin dhe duke dërguar çështjen para Gjykatës Kushtetuese me qëllim ushtrimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së nenit 289/5 të Kodit Doganor, ka tejkaluar kompetencat e veta, pasi kontrolli incidental mund të ushtrohet nga gjyqtari vetëm gjatë shqyrtimit të një çështjeje konkrete dhe jo kur një padi nuk plotëson kushtet formale ose substanciale për t'u marrë në shqyrtim nga gjykata;

Mjeti i kontrollit incidental nga ana e gjykatave të zakonshme mund të përdoret prej këtyre të fundit vetëm në rastet kur pengesa e paraqitur nga kushtetutshmëria e normës ka të bëjë me vendimin që do të merret në rastin konkret nga gjykata. Si rrjedhim gjyqtari mund të pezullonte gjykimin vetëm në rast se do vihej në diskutim kushtetutshmëria e një norme ligjore që do të kishte ndikim në vendimin për shpalljen e aktit administrativ si të vlefshëm ose të pavlefshëm dhe jo si në rastin konkret kur dispozita ka të bëjë me vazhdimin apo jo të gjykimit;

Këshilli i Ministrave pretendon se norma e kontestuar është në përputhje të plotë me nenin 17 të Kushtetutës, pasi përmban një kufizim të vendosur me ligj, për të përmbushur një interes publik, është në përputhje me gjendjen e krijuar dhe si i tillë nuk cenon thelbin e së drejtës së ankimit dhe as nuk tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut;

Kodi Doganor është hartuar me asistencën e përfaqësuesve të Komisionit Europian në Shqipëri (Misionit CAM-Albania) dhe, për rrjedhojë, është në përputhje me standardet bashkëkohore europiane.

C. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

-Vjelja e detyrimeve doganore dhe të ardhurave të tjera buxhetore (penaliteteve), si një atribut tipik i administratës doganore, është një element i rëndësishëm me interes të gjerë publik, pasi mundëson realizimin e pothuajse 50% të fondeve në dispozicion të Buxhetit të Shtetit;

-Parandalimi dhe goditja e rasteve të evazionit fiskal është një atribut i administratës doganore me interes të gjerë publik edhe me ndikimin të padiskutueshëm në të ardhurat publike;

-Kufizimi i konkurrencës së pandershme dhe mbrojtjes së konsumatorit është një tjetër element i rëndësishëm me interes publik;

Për sa sipër këto elemente justifikojnë kufizimet në të drejtat e individëve për të ankimuar vendimet e administratës doganore.

Kufizimet e së drejtës së aksesit në gjykatë janë plotësisht në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, pasi janë bërë me ligj, janë proporcionale, në raport me gjendjen që ka diktuar adoptimin e tyre dhe nuk cenojnë thelbin e së drejtës.

Kodi Doganor është hartuar në bashkëpunim me misionet e specializuara për të dhënë asistencë në fushën doganore të Bashkimit Europian dhe është në përputhje me Kodin Doganor Komunitar.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave tërheq vëmendjen e Gjykatës se aktet e autoriteteve doganore mund të kundërshtohen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm duke goditur titullin ekzekutiv dhe se kjo e drejtë e palës ankuese nuk i nënshtrohet asnjë lloj kufizimi, si rrjedhim nuk jemi para një rasti të kufizimit të së drejtës së ankimit.

III

1. Lidhur me legjitimitimin e kërkesit

E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin si një element thelbësor të saj edhe të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate të pavarur dhe të paanshme. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, si edhe nga nenet 6/1 dhe 13 i KEDNJ.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar edhe më parë në jurisprudencën e saj kushtet kur një gjykatë mund të ushtrojë të drejtën e kontrollit incidental dhe të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e një konflikti të natyrës kushtetuese, ndërmjet një norme ligjore dhe urdhërimit të normës kushtetuese.

Në vendimin nr. 2, datë 3.02.2010 Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar disa kushte që duhet të respektohen nga Gjykata referuese gjatë ushtrimit të kontrollit incidental. Gjykata është shprehur si më poshtë vijon: *“Së pari, gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.”*

Në rastin e kontrollit incidental, gjyqtari i çështjes detyrohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese pasi ai gjendet në pamundësi për të ushtruar funksionet e veta ligjore për arsye se ka dy detyrime. Nga njëra anë ai ka detyrimin të japë drejtësi dhe të zgjidhë në përputhje me ligjin çështjet e shtruara para tij, kurse nga ana tjetër, ai ka detyrimin për të respektuar Kushtetutën dhe parimin e hierarkisë së normave sipas të cilit Kushtetuta ka epërsi ndaj të gjitha normave të tjera juridike.

Për sa më sipër Gjykata çmon se është detyrë e çdo gjyqtari që të vlerësojë nëse palëve në proces u garantohet një e drejtë efektive e aksesit në gjykatë dhe, nëse *prima facie* konstaton se një normë ligjore i kufizon në mënyrë të padrejtë njërës prej palëve mundësinë e aksesit në gjykatë, atëherë ai është i legjitimuar të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk mund të përmbushë detyrimin ligjor që buron jo vetëm nga Kushtetuta por edhe nga KEDNJ.

Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin e saj nr.5, datë 6.03.2009, ku përcaktohet se gjyqtari referues mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, nëse argumenton një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të domosdoshme ndërmjet kushtetutshmërisë së ligjit objekt shqyrtimi dhe zgjidhjes së çështjes konkrete të shtruar para tij.

Posaçërisht lidhur me vendimet administrative, GJEDNJ shprehet se palët kontraktuese duhet të përcaktojnë procedura ligjore të qarta, në bazë të së cilave, vendimet administrative të mund të ankimohen para një gjykate të pavarur dhe të paanshme (shih Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës, 10.02.1983). Ndërsa në vendimin për çështjen Kreuz kundër Polonisë GJEDNJ shprehet se e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë një e drejtë efektive dhe jo formale. Në këtë çështje GJEDNJ merrte në shqyrtim barrierat financiare për t'iu drejtuar gjykatës dhe përcaktonte se këto barrierat duhet të analizohen rast pas rasti, në përputhje me mundësitë reale që ka paditësi dhe jo të merret në shqyrtim një mundësi abstrakte për të paguar nga ana e personit që kërkon të vërë në lëvizje gjykatën.

Mekanizmi i përshkruar nga GJEDNJ është i njëjtë me atë të parashikuar nga neni 158/a i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, në bazë të së cilit gjyqtari ka mundësinë të përjashtojë nga parapagimi i taksës mbi aktet dhe shpenzimet e tjera gjyqësore palën ndërgjyqëse që është në pamundësi për të përballuar këtë barrë financiare që mbart pala që vë në lëvizje gjykatën.

Gjykata Kushtetuese (më poshtë “Gjykata”), nisur nga sa sipër, çmon se gjyqtari i vetëm legjitimohet për të ushtruar kontroll incidental, lidhur me faktin nëse pika 5 e nenit 289 të Kodit Doganor kufizon në mënyrë antikushtetuese të drejtën e aksesit në gjykatë të shtetasve.

2. Lidhur me themelin e kërkesës, kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289, pika 5 të Kodit Doganor

Kërkuesi ka pretenduar se dispozita e mësipërme cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor në një nga elementet e saj thelbësore, në të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6/1 të KEDNJ-së.

Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim ballafaqohen dy interesa të mbrojtura nga Kushtetuta, nga njëra anë, e drejta e shtetasve për të pasur një akses efektiv në një proces të drejtë para një gjyqtari të paanshëm dhe të pavarur, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe, nga ana tjetër, interesi i shtetit për të vjelë në mënyrë efektive detyrimet doganore, qoftë edhe duke kufizuar të drejtën e aksesit të individëve në gjykatë, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

Gjykata, siç ka argumentuar dhe në vendimin e saj nr.16, datë 25.07.2008, vëren se nuk vihet në dyshim që grumbullimi efektiv i detyrimeve që shtetasit kanë kundrejt shtetit përbën një interes të ligjshëm publik, mëse të mjaftueshëm për të justifikuar kufizime të të drejtave të shtetasve, por me kusht që ato të jenë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Një ndërhyrje shtetërore, e cila kufizon të drejta të ligjshme të shtetasve, mund të ndërmerret kur është e domosdoshme dhe nuk ekziston asnjë rrugë tjetër për të mundësuar arritjen e interesave publikë. Ndërhyrja që kufizon të drejtat e shtetasve, në asnjë rast, nuk mund të cenoje thelbin e së drejtës dhe duhet të jetë në

përputhje të plotë me situatën që ka diktuar hartimin e normës kufizuese. Gjykata ka argumentuar se duhet një analizë e kujdesshme nga ana e organit vendimmarrës (në rastin konkret, Kuvendit) në lidhje me mjetin e përdorur për të arritur qëllimin e ligjshëm.

Para së gjithash, mjeti i përdorur duhet të jetë efikas, në mënyrë që të mos kemi një cenim a mohim të të drejtave të individëve pa u arritur realizimi i interesit publik, në funksion të së cilit është hartuar norma juridike. Mjeti duhet të jetë i tillë që të shmangë, sa më shumë të jetë e mundur, kufizimet e të drejtave të individëve në raport me rezultatet që kërkohen të arrihen. Ky konkretizim i parimit të proporcionalitetit detyron ligjvënësin që në çdo rast të vërë në balancë përfitimet publike në raport me cenimin e të drejtave të individëve duke pasur si kufizim logjik dhe juridik të përfitimeve publike, thelbin e të drejtës së individëve.

Në vendimin nr.9, datë 2.04.2003, Gjykata Kushtetuese shprehet se dispozitat objekt kërkese kushtëzojnë të drejtën e ankimit me pagimin paraprak të vlerësimit tatimor, gjë që përbën kufizim të kësaj të drejte. Po në këtë vendim thuhet, se si çdo e drejtë subjektive, edhe e drejta e ankimit nuk e përjashton mundësinë që ligjvënësi të vendosë kufizime në ushtrimin e saj për të mbrojtur një interes publik ose të drejtat e të tjerëve, por këto duhet të bëhen me kusht që të garantojnë zbatimin e urdhërimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, pra që kufizimi të bëhet me ligj, të bëhet në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, të mos cenoje thelbin e së drejtës dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Nisur nga sa më sipër Gjykata analizoi faktin nëse vjelja e detyrimeve tatimore mund të arrihej pa vendosur kufizime të aksesit të individëve për t'iu drejtuar gjykatës, të cilat mund të prekin thelbin e së drejtës. Duke qenë se nga ana e subjekteve të interesuara është pretenduar se masat e marra kanë për qëllim rritjen e efikasitetit lidhur me vjeljen e detyrimeve që individët kanë ndaj organeve shtetërore, Gjykata vëren se legjislacioni administrativ në fuqi u jep mundësinë organeve doganore të bëjnë të mundur vjeljen efektive të detyrimeve, pa kufizuar të drejtën e aksesit në gjykatë të shtetasve.

Në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë thuhet se ekzekutimi i detyrimeve të parashikuara në aktin administrativ mund të bëhet forcërisht nga administrata, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar gjykatës, me kusht që ekzekutimi të bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit (shih nenin 130).

Ndërsa në nenin 138 të këtij Kodi parashikohet se ankimi administrativ pezullon zbatimin e aktit administrativ me përjashtim të rastit kur akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore.

Në këto kushte Gjykata arrin në përfundimin se organet doganore i kanë të gjithë tagrat që të veprojnë me anë të ekzekutimit të detyruar kundrejt debitorëve të tyre, të cilët edhe nëse ankohen, nuk kanë të drejtë të përfitojnë pezullimin e ekzekutimit kundrejt pasurisë së tyre, si pasojë e ankimit administrativ ose gjyqësor. Pikërisht për këto arsye Gjykata, ashtu si dhe në rastin e gjobave tatimore (*shih vendimin nr.16, datë 25.07.2008*), vlerëson se objektivi i ligjshëm shtetëror për të rritur efektivitetin e vjeljes së detyrimeve doganore mund të realizohet pa cenuar të drejtën e individëve për t'iu drejtuar gjykatës.

Të njëjtin mjet juridik, pra ekzekutimin forcërisht të vendimeve të autoriteteve doganore, pa pezulluar këtë ekzekutim në rastin e ankimit e gjejmë edhe në Rregulloren (EEC) No.2913/92 e cila krijonte Kodin Doganor Komunitar.

Palët e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kanë pretenduar se neni 289/5 është i harmonizuar me Kodin Doganor Komunitar. Gjykata pasi shqyrtoi dispozitat e këtij Kodi arriti në përfundimin se mbështetja në Kodin Doganor Komunitar për të justifikuar kufizimet e aksesit të shtetasve në gjykatë është fryt i një interpretimi të gabuar të Kodit Komunitar European.

Në preambulën e Kodit Doganor Komunitar thuhet se në mënyrë që të sigurohet një balancë ndërmjet nevojës së autoriteteve doganore, për të garantuar një aplikim korrekt të legjislacionit doganor në njërën anë dhe të drejtës së tregtarëve për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë në anën tjetër, autoriteteve të mësipërme duhet t'u garantohen *inter alia* fuqi të zgjeruara kontrolli dhe tregtarëve të mësipërm e drejta e ankimit (shih paragrafin 9).

Konkretisht, e drejta e ankimit, siç pranon edhe Këshilli i Ministrave në parashtrimet e veta, rregullohet në titullin VIII të Kodit Doganor Komunitar, në nenin 243 të të cilit thuhet se: “Çdo person do të ketë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të autoriteteve doganore, të cilat lidhen me zbatimin e legjislacionit doganor dhe që kanë të bëjnë me ankuesin, drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë individuale.”

Ndërsa në nenin 244 të këtij Kodi, parashikohet se autoritetet doganore, gjithsesi, do të ndërpresin zbatimin e vendimit të ankimuar, plotësisht ose pjesërisht, kur kanë arsye të besojnë se vendimi bie në kundërshtim me legjislacionin doganor, ose në rastet kur është për t’u pasur frikë se një dëm i riparueshëm mund t’u shkaktohet subjekteve të prekura nga vendimi.

Këto dispozita duhen shqyrtuar në raport edhe me formulimin e nenit 232 të Kodit, sipas të cilit kur shuma që përbën detyrimin nuk është paguar në afatin e caktuar, autoritetet doganore do të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm të lejuar nga legjislacioni në fuqi, përfshirë ekzekutimin e detyrueshëm, për të siguruar përmbushjen e detyrimit.

Qëllimi i këtyre dispozitave është që t’u japin mundësinë autoriteteve doganore që të bëjnë sa më efikase vendimet e tyre dhe mënyra më e mirë për të bërë këtë të fundit është ekzekutimi me forcë i sendeve në posedim të kreditorit. Me fjalë të tjera, autoritetet doganore nuk pengohen të sekuestrojnë mallrat e debitorit të gjendura në posedimin e tyre edhe pse debitori mund të ketë paraqitur një ankim administrativ pranë autoriteteve doganore ose pranë autoritetit gjyqësor.

Për sa sipër Gjykata vlerëson se kushti i vendosur në nenin 289, pika 5 të Kodit Doganor për pagimin e gjobës për të pasur akses në gjykatë përbën një kufizim jo proporcional dhe për pasojë, një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42, pasi kufizimet e parashikuara nuk janë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “d” të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69 dhe 70 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikës 5 të nenit 289 të Kodit Doganor, vetëm në pjesën ku thuhet: “...apeluesi duhet të paguajë pjesën e mbetur prej 60 për qind të gjobës.”

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Petrit Pilloçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza

MENDIM PAKICE

Jemi për rrëzimin e kërkesës për arsyet e mëposhtme:

Kushti i vendosur në nenin 289, pika 5 e Kodit Doganor për pagimin e gjobës për të pasur akses në gjykatë nuk përbën kufizim jo proporcional dhe ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, siç arsyetohet shumica.

E drejta kushtetuese e individëve për t’iu drejtuar gjykatës nuk kufizohet nga përmbajtja e nenit të kundërshtuar për faktin, se subjektet e interesuara, disponojnë edhe mjete/mundësi të tjera procedurale për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në këtë kuptim, neni i kundërshtuar duhet lexuar si pjesë përbërëse e tërësisë së normave të Kodit Doganor dhe jo i veçuar prej tyre. Kështu, neni 245 i Kodit Doganor parashikon se: “Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, bëhen tituj ekzekutivë menjëherë

sapo ato i njoftohen debitorit. Ekzekutimi i vendimeve të sipërpërmendura bëhet në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 dhe në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Titujt ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, menjëherë sapo mbështeten me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga organet e administratës doganore.” Duke qenë se vendimi i administratës, në momentin që i njoftohet debitorit kthehet në titull ekzekutiv, debitori pikërisht në këtë moment, bazuar në rregullimet e nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile”... mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit, që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas...Në këto raste, gjykata shqyrton shpejt çështjen dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci”. Në kuptim të kësaj norme, debitorit i lind e drejta të ushtrorë padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, gjë që përbën garanci procedurale të tillë, që i mundëson debitorit të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës.

Nga sa më sipër rezulton se neni 289/5 i Kodit Doganor nuk është norma e vetme që, për zgjidhjen e rastit konkret, mundëson apo kufizon aksesin e subjekteve në gjykim. Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile u mundëson subjekteve një tjetër mjet procedural, atë të padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv për kundërshtimin e vendimeve të marra nga administrata doganore si për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor. Kjo padi, e cila është në disponimin e individit që vë në lëvizje gjykatën e zakonshme shqyrtohet nga kjo e fundit pa u kushtëzuar nga ankimi administrativ apo nga rregullimet e nenit 289/5 të Kodit Doganor dhe, në çdo rast, i nënshtrohet parimeve themelore të një procesi të rregullt ligjor.

Nga sa më sipër, mundësia që ka individit për të ngritur edhe padi të tjera të cilat jo domosdoshmërisht kërkojnë vendosjen e garancisë pasurore, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, përbën garanci për ushtrimin e të drejtës për t’ju drejtuar gjykatës.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Vitore Tusha.

VENDIM
Nr.19, datë 28.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 28.04.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Sokol Sadushi.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 dhe 179/1 të Kushtetutës, si dhe nenet 8/2 dhe 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Zoti Sokol Sadushi, me vendimin nr.358, datë 23.4.1998 të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr.7491, datë 24.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, është zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për një mandat 12-vjeçar.

Nga të dhënat rezultojnë se gjyqtari Sokol Sadushi betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 27.04.1998. Për rrjedhojë bazuar në nenin 179/1 të Kushtetutës, si dhe në nenin 8/3 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, data 27.04.2010 konsiderohet edhe si data e mbarimit të mandatit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Sokol Sadushi, në datën 27.04.2010.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi

VENDIM Nr.20, datë 28.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

		Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“	
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“	
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“	
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“	
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“	
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“	
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“	

me sekretare Blerina Çinari, në datë 28.04.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Fehmi Abdiu.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 dhe 179/1 të Kushtetutës, si dhe nenet 8/2 dhe 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Zoti Fehmi Abdiu, me vendimin nr.358, datë 23.4.1998 të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr.7491, datë 24.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, është zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për një mandat 12-vjeçar.

Nga të dhënat rezulton se gjyqtari Fehmi Abdiu betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 27.04.1998. Për rrjedhojë bazuar në nenin 179/1 të Kushtetutës, si dhe në nenin 8/3 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, data 27.04.2010 konsiderohet edhe si data e mbarimit të mandatit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Fehmi Abdiu, në datën 27.04.2010.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi.

VENDIM

Nr.21, datë 29.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 4.03.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.3 Akti, që i përket:

KËRKUESI: FLORIAN MEÇE, i përfaqësuar nga avokat Eva Dyrmishi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Artur Selmani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 14, datë 3.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.212, datë 31.10.2001, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit Florian Meçe për kryerjen e veprave penale të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake” dhe “vrasjes me paramendim, në bashkëpunim” dhe, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, e ka dënuar atë me 22 vjet burg. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.305, datë 20.12.2001, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.212, datë 31.10.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.566, datë 23.10.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.305, datë 20.12.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

2. Vendimi gjyqësor i formës së prerë është ekzekutuar në muajin shtator të vitit 2007, kohë në të cilën është pranuar kërkesa e shtetit shqiptar për ekstradimin e kërkuarit nga Spanja. Ekstradimi u bë i mundur me vendim të Gjykatës së Lartë Kombëtare Spanjolle (sek.II), pasi u kërkua prej saj garancia për rigjykimin e subjektit, për shkak të dhënies së vendimit gjyqësor nga gjykatat shqiptare, në mungesë të tij. Siç konfirmohet nga shkesa nr.1549/1 Prot.O.F., datë 25.02.2010, nga ana e shtetit shqiptar, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë është dhënë garancia për respektimin e së drejtës për rigjykim të subjektit, në zbatim të Kushtetutës dhe të neneve 147, 148, 449, 450, 453 të Kodit të Procedurës Penale.

3. Mbi bazën e garancisë së dhënë nga shteti shqiptar, menjëherë pas ekstradimit, kërkuari ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë. Me qëllim realizimin e së drejtës për t'u rigjykuar, kërkuari ka pretenduar si shkaqe ligjore për rishikimin e vendimeve zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij, hetimin e paplotë, kufizimin e të drejtës për t'u mbrojtur si dhe, garancinë e dhënë nga Ministria e Drejtësisë për rigjykimin e çështjes. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.14, datë 03.10.2008, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr.212, datë 31.10.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.14, datë 3.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me pretendimin, se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Si shkaqe ligjore për shfuqizimin e këtij vendimi gjyqësor, kërkuari ka parashtruar: (i) shkeljen e parimit të barazisë së armëve; (ii) zhvillimin e gjykimit në mungesë; (iii) mangësitë në arsyetimin e vendimit gjyqësor; (iv) mohimin e mundësive efektive ligjore për mbrojtje ligjore; (v) moszbatimin e parimit të paanësisë, për shkak të marrjes pjesë në gjykimin e kërkesës për rishikim të të njëjtit gjyqtar, i cili ishte shprehur më parë për fajësinë e kërkuarit; (vi) cenimin e së drejtës për rigjykimin e tij, megjithëse shteti shqiptar kishte dhënë garanci për zhvillimin e një procesi gjyqësor, në të cilin do të siguroheshin standardet e gjithëpranuara të mbrojtjes. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 74, datë 18.09.2009, ka vendosur “moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”.

5. Kërkuari ka paraqitur një tjetër kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kërkuari pretendon se Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 74, datë 18.09.2009 nuk i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesë. Për një nga pretendimet që lidhet me njëanshmërinë në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese e ka marrë në shqyrtim, por ka vendosur në kundërshtim të hapur me praktikën e përcaktuar prej Gjykatës Kushtetuese, duke cenuar në këtë mënyrë sigurinë juridike. Kërkuari ka vënë theksin në pretendimin, për cenimin e protokollit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ekstradimin, të datës 17.3.1978, ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë”, pretendim të cilin Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në vendimin e

mëparshëm, nuk e ka shqyrtuar. Pretendimet e tjera janë pothuajse të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën e parë.

6. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar Prokuroria e Përgjithshme, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar se:

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.74, datë 18.09.2009, ka marrë në shqyrtim kërkesën e shtetasit Florian Meçe dhe pasi ka argumentuar se nuk ndodhet përpara shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Rishqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese i të njëjtave pretendime, që lidhen me të njëjtën çështje dhe ndaj të njëjtit person do të përbënte shkelje të parimit *ne bis in idem* dhe të parimit të sigurisë juridike. Lidhur me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike, kërkuesi duhet t'i drejtohej Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jo Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara.

II

A. Në lidhje me pretendimin e subjektit të interesuar për mosshqyrtimin dhe pushimin e çështjes nga Gjykata Kushtetuese.

7. Gjykata Kushtetuese (këtu e në vijim: Gjykata) vlerëson se, përpara se të shqyrtojë pretendimet e kërkuarit në lidhje me thelbin e çështjes, duhet të analizojë dhe t'i përgjigjet pretendimit të përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në lidhje me shqyrtimin nga Gjykata të së njëjtës kërkesë dhe me të njëjtat pretendime. Pamundësinë e Gjykatës për ta shqyrtuar përsëri këtë çështje, përfaqësuesi i subjektit të interesuar e ka lidhur me cenimin e parimit *ne bis in idem* dhe të parimit të sigurisë juridike

8. Kërkesa në shqyrtim është gjykuar nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (këtu e në vijim: Kolegji), i cili me vendimin nr.74, datë 18.09.2009 ka vendosur “Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”. Nga analiza integrale e këtij vendimi, Gjykata vëren se, ndonëse kërkuesi ka ngritur një sërë pretendimesh, Kolegji, në vendimin e tij i ka dhënë përgjigje vetëm pretendimeve në lidhje me “zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuarit apo mbrojtësit të tij” dhe “të parimit të paanësisë së gjykatës”, ndërkohë që nuk rezulton të jetë evidentuar në vendim dhe të ketë marrë përgjigje pretendimi i kërkuarit mbi “garancinë e dhënë nga shteti shqiptar për rigjykimin e tij dhe garantimin e një procesi ku do të siguroheshin standardet e gjithëpranuara të mbrojtjes”.

9. Mosshqyrtimi nga Kolegji i shkakut ligjor që lidhet me garancinë e dhënë nga shteti shqiptar për rigjykimin e kërkuarit, nuk krijon pengesë për Gjykatën që ta përfshijë këtë çështje në juridiksionin e saj kushtetues. Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga ligji i saj organik, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (shih më gjerë vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vënë theksin në kuptimin formal e procedural, të parimit të ndalimit *res iudicata* – gjësë së gjykuar, si në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ashtu edhe të fuqisë së tij detyruese. Gjykata ka nënvizuar se “...tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur nuk është shprehur papajtueshmëria kushtetuese e normës juridike, kërkuesi nuk ndalohet të bëjë përsëri të njëjtën kërkesë me motiv rishikimin e normës për papajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo gjë varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera.” (shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 21.12.2006).

11. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit nuk përbën pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që kërkuesi pret një qëndrim përfundimtar të Gjykatës për ato shkaqe, për të cilat ajo nuk i ka shqyrtuar më parë. Në kërkesën e re, objekt shqyrtimi, kërkuesi ka parashtruar një shkak të ri, atë të rigjykimin për efekt të garancive të dhëna nga shteti shqiptar, që nuk është shqyrtuar në vendimin e Kolegjit. Për pasojë, Gjykata çmon se në rastin konkret nuk vepron parimi *res iudicata*.

B. Në lidhje me pretendimin për gjykimin e çështjes nga një gjykatë e njëanshme.

12. Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është gjykimin e çështjes nga një gjykatë e paanshme. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimin e çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshmëri e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se "...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje" (*shih vendimin nr. 48, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim rezulton se në trupën e gjyqtarëve që përbënin Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, që me vendimin nr.266, datë 23.10.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.305, datë 20.12.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë, sikundër dhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), që me vendimin nr.14, datë 03.10.2008, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e këtyre vendimeve, ka qenë prezent i njëjti gjyqtar. Gjykata çmon se një fakt i tillë nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë, për çështje të ndryshme. Por i ndryshëm është qëndrimi, kur i njëjti gjyqtar apo gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore. Rezulton se një nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët kanë shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe kanë konkluduar për drejtësinë e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, që ka lënë në fuqi dënimin e tij me 22 vjet burg, ka shqyrtuar dhe ka konkluduar edhe për mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit, të dhënë prej tyre. Gjykata vlerëson se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuetit në të dy gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore. Pjesëmarrja e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në dy vendimet e dhëna për të njëjtat rrethana të pretenduara, (ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimin) ka krijuar një dyshim të justifikuar te kërkuesi se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm.

15. Duke iu referuar qëndrimit të mbajtur me vendimin nr. 74, datë 18.09.2009, Gjykata konstaton se pavarësisht vendimmarrjes së saj të konsoliduar në lidhje me konceptin "*gjykatë e paanshme*," Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, duke vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë, rezulton se ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm për mënyrën e gjykimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë.

16. Gjykata thekson se nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (*shih vendimin nr.5, datë 7.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky efekt

detyruet ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata thekson se efekti detyruet që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.06.2009*). Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëj përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese.

17. Gjykata thekson se në aspektin kushtetues është e pamundur dhe e palejueshme që doktrina kushtetuese zyrtare të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra-tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara dhe që ndryshon modelin e ndarjes së pushteteve të rregulluara në Kushtetutë. Çdo ndryshim i “precedentëve të Gjykatës Kushtetuese apo korrigjim i doktrinës kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, siç mund të jetë edhe ndryshimi i përbërjes së saj” (*shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë të datës 28 mars 2006*). Sigurimi i vazhdimësisë së jurisprudencës kushtetuese përbën një detyrim për Gjykatën, por nga ana tjetër, në mënyrë të natyrshme jurisprudenca nuk mund të mos i nënshtrohet edhe evoluimit të saj. Nga kjo pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca duke u plotësuar përmes konkluzioneve të reja interpretuese, edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivist e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar. Duke vendosur në kundërshtim me një praktikë të konsoliduar dhe pa dhënë argumente në lidhje me këtë fakt, Gjykata shmanget nga korniza e rregullave të një procesi të drejtë e të ndershëm, duke i mohuar mbrojtjen gjyqësore kërkuesit në kuptim të asaj se çfarë ky i fundit priste, bazuar në jurisprudencën e vetë Gjykatës (*Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Çekisë nr. IV. US 451/05, datë 17.07.2007*).

18. Bazuar në këtë arsyetim, të ndikuar edhe nga doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese, Gjykata vlerëson se, në rastin në shqyrtim, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese nuk rezulton të ketë pasur arsye të përligjura për të ndryshuar qëndrimin konsekuent të jurisprudencës kushtetuese, në lidhje me cenimin e parimit të paanësisë. Për rrjedhojë, Gjykata konkludon se në kuptim edhe të standardit për një qëndrueshmëri në vendimmarrjen kushtetuese, pretendimi i kërkuesit për pjesëmarrjen e të njëjtit gjyqtar në të njëjtën çështje, ka cenuar një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivist e paanshme. Për rrjedhojë, kërkesa sa i përket këtij pretendimi të kërkuesit është e bazuar dhe duhet pranuar (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 1.10.2008 dhe nr.1, datë 25.01.2010*).

C. Në lidhje me pretendimin mbi garancinë e dhënë nga shteti shqiptar për rigjykimin e të ekstraduarit, me qëllim respektimin në proces të së drejtës së mbrojtjes.

19. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk ka respektuar normat e së drejtës ndërkombëtare që lidhen me ekstradimin. Nga materialet që ndodhen në dosje rezulton se ekstradimi i shtetasit Florian Meçe nga Mbretëria e Spanjës është bërë i mundur vetëm pasi shteti shqiptar ka pranuar, përmes Ministrit të Drejtësisë, të përmbushë angazhimin e marrë përpara shtetit spanjoll se do të siguronte rigjykimin e kërkuesit. Gjykata thekson se detyrimi për të garantuar paraprakisht respektimin e së drejtës për rigjykim të të ekstraduarit vjen si pasojë e ratifikimit nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998 të Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë, në nenin 2 të të cilës parashikohet se: “Kur një nga shtetet palë kërkon nga shteti tjetër palë ekstradimin e një personi për qëllim të ekzekutimit të një vendimi ose dënimi të vendosur nga një vendim i dhënë ndaj tij *in absentia*, pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin, nëse, sipas saj, procedurat që çuan në marrjen e atij vendimi nuk kanë kënaqur të drejtat minimale të mbrojtjes të njohura për çdo person që akuzohet penalisht. Megjithatë, ekstradimi mund të lejohet nëse pala kërkuese jep siguri të mjaftueshme se do të garantojë të drejtën e pretenduar të personit për një rigjykim, i cili do të sigurojë të drejtat e mbrojtjes. Vendimi për lejimin do të autorizojë palën kërkuese ose të zbatojë

vendimin në fjalë nëse personi i dënuar nuk e kundërshton këtë, ose, nëse ai e kundërshton, të zhvillojë procedurat kundër personit të ekstraduar”. Në të njëjtën kohë, bazuar në zhvillimet e reja të legjislacionit në fushën penale, rezulton se është miratuar ligji nr.10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i cili nëpërmjet nenit 51, ka krijuar bazën e përshtatshme ligjore për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nëpërmjet detyrimeve që shteti shqiptar merr përsipër të realizojë për të përfutur një dimension më të plotë, sa i përket mbrojtjes që siguron parimi i procesit të rregullt ligjor.

20. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se me vendimin nr.14, datë 3.10.2008, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka arsyetuar se: “...në kërkesën për rishikim, kërkuesi Florian Meçe nuk parashtron asnjë nga shkaqet që parashikohen në dispozitën e nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale, për të cilat mund të kërkohet rishikimi i vendimit penal të formës së prerë”. Këtë qëndrim të Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë në korrespondencën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese e konsideron si një situatë që ka krijuar “...në disa raste edhe precedentin negativ për shtetet e huaja, lidhur me imazhin e mosrespektimit të garancive të dhëna për rigjykimin e këtyre shtetasve.”

21. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos e vlerësuar garancinë për rigjykim që parashikohet nga Konventa për Ekstradimin, jo vetëm që ka shkelur një detyrim ligjor ndërkombëtar por, në të njëjtën kohë, nuk i ka krijuar as mundësinë për të qenë i pranishëm në seancë, me qëllim respektimin e parimit të barazisë së armëve. Pretendimin e kërkuesit për të qenë i pranishëm në seancë, në rastin në shqyrtim, Gjykata nuk e lidh me pjesëmarrjen e domosdoshme të kërkuesit në dhomën e këshillimit, por me mundësinë që iu duhet dhënë palëve për t’iu respektuar të drejtën për rigjykim, në kuptim të garancive që jepen nga shteti shqiptar, sipas ligjit nr. 8322, datë 2.4.1998 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë”. Gjykata vlerëson se interpretimi dhe zbatimi i legjislacionit penal dhe, në veçanti, shqyrtimi i ekzistencës ose jo të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimit, në çështjen konkrete, mbetet një atribut i vlerësimit për Gjykatën e Lartë.

22. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, në kuptim të rregullimeve të parashikuara në nenin 122 të Kushtetutës, interpretimi i konceptit kushtetues të vetzbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të, është në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka në juridiksionin e vet zgjidhjen përfundimisht të çështjes konkrete.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 14, datë 3.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Admir Thanza.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Vitore Tusha.

MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës për arsye se kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi ai nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

1. Standardi kushtetues i shterimit të mjeteve, sanksionuar nga neni 131, shkronja “f” e Kushtetutës, nënkupton se kërkuesi për të rivendosur të drejtën që pretendon se i është cenuar, jo vetëm që duhet t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por edhe që të gjitha pretendimet që ka për qëllim t’i ngrëjë në këtë Gjykatë, t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë dhe, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.14, datë 03.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka pasur si objekt rishikimin e vendimit penal nr.212, datë 31.10.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

3. Kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datë 21.12.2009. Përpara se çështja të kalonte për shqyrtim në seancë plenare është miratuar dhe ka hyrë në fuqi ligji nr.10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i cili në nenin 51/4 parashikon rishikimin e një vendimi penal të formës së prerë me kërkesë të të ekstraduarit, të dënuar në mungesë, nëse Ministri i Drejtësisë i ka dhënë garanci të tilla shtetit të kërkuar. Kërkesa për rishikim paraqitet brenda 30 ditëve nga mbërritja e të ekstraduarit në territorin shqiptar dhe shqyrtimi i saj ndjek rregullat e Kodit të Procedurës Penale (nenet 449 - 461).

4. Ushtrimi i kërkesës për rishikim kushtëzohet nga ekzistenca e shkaqeve të përcaktuara në nenin 450 të Kodit të Procedurës Penale. Legjislati procedural penal nuk e kufizon nga pikëpamja kohore (afate ligjore apo prekluzive) ushtrimin e këtij mjete dhe nuk ndalon që kërkesa për të rishikuar një vendim penal të formës së prerë të paraqitet më shumë se një herë në rastet kur rezultojnë shkaqet që parashikon neni 450 i Kodit të Procedurës Penale.

5. Në çështjen në gjykim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e kërkesës së tij për rishikim, e cila, në aspektin formal, siç u përmend dhe më lart, nuk kufizohet nga Kodi i Procedurës Penale për t’u ushtruar përsëri (neni 461). Ligji nr.10193, datë 3.12.2009 parashikon rihapjen e procesit gjyqësor për kategoritë e të gjykuarve të cilët janë dënuar në mungesë dhe janë ekstraduar mbi bazën e garancisë së dhënë nga Ministri i Drejtësisë. Kjo kategori subjektsh, ku përfshihet edhe kërkuesi, ka të drejtë të ushtrojë kërkesën për rishikim nëse plotëson kushtet e lartpërmendura.

6. Shkaqet për të cilat kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese janë të tilla që, në vështrim të nenit 51/4 të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009 bëjnë të mundur rishikimin e vendimit të formës së prerë nga Gjykata e Lartë dhe jo vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Në kuptim të shterimit të mjeteve sipas nenit 131/f, kërkesa për rishikim, si mjet i jashtëzakonshëm procedural, jo domosdoshmërisht duhet të jetë ushtruar/shteruar paraprakisht. Ky rregull nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi mundësia që neni 51/4 i ofron kërkuesit që të ushtrojë kërkesën për rishikim të vendimit të formës së prerë (për të njëjtat shkaqe që ai parashtron para Gjykatës Kushtetuese), nuk është gjë tjetër veçse mjet ankimi i paezauruar, që në vështrim të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës, duhet shteruar.

7. Shumica, duke legjitimuar kërkuesin, ka vlerësuar se janë shteruar mjetet juridike në dispozicion të tij dhe pa shfuqizuar vendimin e mospranimit të Kolegjit Seleksionues për të njëjtën kërkesë, ka marrë në shqyrtim kërkesën e dytë të paraqitur prej kërkuesit. Kjo vendimmarrje e shumicës vë në dyshim respektimin e gjësë së gjykuar nga vetë Gjykata Kushtetuese e për rrjedhojë, edhe të parimit të sigurisë juridike.

8. Sa më sipër, në vështrim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike përpara paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

Anëtare: Vitore Tusha

MENDIM I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës për arsye të mëposhtme:

1. Kërkuesi Florian Meçe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën me objekt: “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.14, datë 3.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit)”.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi është deklaruar fajtor me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.212, datë 31.10.2001 për veprat penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim e mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe në bazë të neneve 78/2, 278/2 e 55 të Kodit Penal është dënuar me 22 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.305, datë 20.12.2001, e më pas edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.566, datë 23.10.2002.

Gjykimet janë zhvilluar në mungesë të të pandehurit, i cili ishte larguar nga vendi në drejtim të Spanjës.

3. Me dekretin nr.54/06, datë 5.12.2006, Gjykata e Lartë Kombëtare e Spanjës, me ndërhyrjen e autoriteteve të shtetit shqiptar, ka vendosur ekstradimin e kërkuesit Florian Meçe duke i kërkuar njëkohësisht shtetit tonë dhënien e garancive për riçeljen e procesit dhe respektimin e së drejtës së mbrojtjes, në mbështetje të protokollit të dytë shtesë të “Konventës Europiane për ekstradimin”, meqenëse gjykimi i tij nga gjykatat shqiptare ishte bërë në mungesë.

4. Me shkresën nr.120/2 prot, datë 11.04.2007, Ministria e Drejtësisë ka garantuar në emër të shtetit shqiptar se do të respektohej e drejta e Florian Meçes për rigjykim në zbatim të Kushtetutës dhe neneve 147, 148, 449, 450, 453 të Kodit të Procedurës Penale. Përfundimisht vendimi i gjykatës spanjolle ka marrë formë të prerë dhe është ekzekutuar në shtator të vitit 2007.

5. Menjëherë pas ekstradimit në Shqipëri, Florian Meçe ka paraqitur kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë me arsyetimin se gjykimi ishte bërë në mungesë të tij, duke iu mohuar e drejta e mbrojtjes, në respekt edhe të garancive të dhëna shtetit spanjoll nga shteti shqiptar për respektimin e së drejtës së tij për rigjykim.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.14, datë 3.10.2008, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr.212, datë 31.10.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

7. Më datë 17.07.2009, kërkuesi Florian Meçe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Lartë duke pretenduar se i janë cenuar të drejtat themelore kushtetuese si më sipër të cilat e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt.

8. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.74, datë 18.09.2009 ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare.

9. Më datë 12.01.2010, kërkuesi Florian Meçe depoziton përsëri në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë tjetër për të njëjtën çështje.

10. Shumica, në kundërshtim me vendimin e marrë më parë nga kolegji i Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare, e më pas, pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.14, datë 3.10.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

11. Duke vepruar në këtë mënyrë shumica ka gabuar si nga pikëpamja formale juridike ashtu dhe në aspektin e thelbit juridiko-kushtetues. Në kundërshtim me argumentet që përdor shumica në vendim, nga krahasimi i dy kërkesave të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, rezulton se ato janë identike si përsa i përket çështjes së cilës i referohen ashtu dhe renditjes të shkaqeve të natyrës kushtetuese që sipas kërkuesit e bëjnë vendimin e Gjykatës së Lartë të cenueshëm.

12. Vendimi i shumicës vjen në kundërshtim me një nga parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare të njohur si parimi *ne bis in idem*, ose siç njihet në të drejtën penale, ndalimi i rishqyrtimit të një çështjeje të gjykuar më parë, *res iudicata* (parimi i gjësë së gjykuar). Këto parime vlejnë edhe për vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

13. Nuk mund të ketë dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje nga e njëjta gjykatë pavarësisht se njëri është vendim i kolegjit dhe tjetri i marrë nga shumica pas shqyrtimit të çështjes në seancë plenare. Nga pikëpamja juridike të dyja vendimet kanë vlerë të njëjtë. Për më tepër, si 2250

Kushtetuta ashtu dhe ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, nuk i ka njohur në asnjë rast të drejtën Gjykatës Kushtetuese të rishikojë apo shfuqizojë vendimet e saja edhe nëqoftëse ato janë vendime të marra nga kolegji apo mbledhja e gjyqtarëve. Të vetmet hapësira që i janë lënë kësaj Gjykate me ligj, kanë të bëjnë me interpretimin dhe plotësimin e vendimit. Kështu në nenin 80 të ligjit të sipërpërmendur thuhet shprehimisht:

“...1. Gjykata Kushtetuese nuk mund të anulojë ose të ndryshojë vendimin e saj, por ajo ka të drejtë:

a) të interpretojë vendimin në rast dyshimi ose mosmarrëveshje për kuptimin e tij, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen;

b) të plotësojë vendimin ose të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të...”

14. E vetmja rrugë për ndreqjen e vendimeve të gabuara të Gjykatës Kushtetuese dhe rivendosja e një të drejte kushtetuese të shkelur, mbetet dërgimi i çështjes nga subjektet e interesuara në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Për arsyet e mësipërme, jam i mendimit se Gjykata duhet të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës të Florian Meçes si të pabazuar në Kushtetutë dhe ligj.

KRYETAR
Vladimir Kristo

VENDIM
Nr.22, datë 5.5.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 7.07.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.13/6 Akti, që i përket:

KËRKUES:BASHKIA E TIRANËS, përfaqësuar nga Migena Vishko, Natasha Kondi dhe Rezarta Ismailaj, me autorizim.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës për të ushtruar kontroll mbi njësinë e qeverisjes vendore (Bashkia Tiranë), nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

2. Shfuqizimi i vendimit nr. 249, datë 24.04.2009 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e Komisionit Hetimor”.

3. Pezullimi i zbatimit të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 249, datë 24.04.2009 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor”.

BAZA LIGJORE: Nenet 124/1, 131/ç, 134/1/e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 45, 54 dhe 56/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesit e kërkuessit, që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e saj dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr. 249, datë 23.04.2009, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ngritjen e Komisionit Hetimor për “Shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës”.

Kuvendi i Shqipërisë, me shkresën datë 24.04.2009, i ka komunikuar Bashkisë Tiranë kërkesën e Komisionit Hetimor për të dërguar pranë këtij të fundit praktikave e plota të lejeve të ndërtimit të dhëna nga Këshilli i Rregullimit të Territorit (KRRT) i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1 janar 2007 e në vazhdim.

Bashkia Tiranë, e përfaqësuar nga kryetari i saj, me kërkesën datë 27.04.2009, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 249 të Kuvendit të Shqipërisë që ka sjellë lindjen e kësaj mosmarrëveshjeje, duke pretenduar se ky vendim është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe, se objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor përbën tejkalim të funksioneve të Kuvendit dhe ndërhyrje në kompetencat e organeve të qeverisjes vendore.

Më datë 15.05.2009, Komisioni Hetimor i ka paraqitur për miratim Kuvendit të Shqipërisë raportin përfundimtar të hetimit.

Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 252, datë 15.05.2009, ka vendosur miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor; dërgimin e raportit përfundimtar Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e çështjes penale për personat që eventualisht kanë abuzuar me detyrën dhe funksionin publik; konstatimin e pavlefshmërisë së vendimeve të KRRT-së së Bashkisë së Tiranës të datës 17 prill 2009 dhe ngarkimin e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (ILDKP) që, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, të ndërmarrin masat ligjore në përputhje me nenin 40/6, shkronja “b” të ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Përfaqësuesit e kërkuessit, Bashkia Tiranë, në mënyrë të përmbledhur, kanë argumentuar se:

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore (neni 13 i Kushtetutës); miratimi i lejeve të ndërtimit përfshihet në konceptin ligjor “*funksione të veta*” të organeve të qeverisjes vendore; mbikëqyrja e veprimtarisë së autoriteteve vendore duhet të sigurojë vetëm garantimin e pajtueshmërisë së kësaj veprimtarie me ligjin (neni 8 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore); në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve (neni 7 i Kushtetutës), asnjë organ apo institucion, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese; në këtë kuptim, komisionet hetimore veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit dhe ngrihen për çështje të veçanta, të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit dhe që nuk sjellin konfondime dhe transferime kompetencash të parashikuara nga Kushtetuta; vendimi nr. 249 i Kuvendit ka kapërcyer këtë tagër të legjislativit, pasi rezulton se objekt hetimi i komisionit hetimor janë bërë çështje dhe aspekte, të cilat, në këndvështrimin kushtetues, nuk e legjitimojnë atë të ushtrojë kontroll hetimor ndaj organeve vendore; ngritja e këtij komisioni hetimor është miratuar në kundërshtim me ligjin për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore, i cili përcakton se: “Komisionet hetimore nuk mund të ngrihen gjatë 4 muajve para mbarimit të mandatit të Kuvendit”.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, kërkoi rrëzimin e kërkesës duke argumentuar, në mënyrë të përmbledhur se:

i) në lidhje me legjitimitimin e kërkuessit

Kërkesa para Gjykatës Kushtetuese nuk është ngritur nga një prej subjekteve në konflikt ose të cenuara drejtpërdrejt nga konflikti; vendimi objekt shqyrtimi ka pasur fuqi juridike deri në përfundimin e veprimtarisë së komisionit hetimor dhe, pas humbjes së fuqisë së tij juridike, nuk mund të shkaktojë mosmarrëveshje kompetencash; ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe një organi të qeverisjes vendore nuk mund të krijohet mosmarrëveshje kompetence, pasi Kuvendi nuk përfshihet në konceptin e pushtetit qendror; kërkuesi duhej të argumentonte se i është marrë një kompetencë e tij.

ii) në lidhje me themelin e kërkesës

Ndërsa kërkuesi pretendon se Kuvendi, me vendimin e tij, ka cenuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve, qeverisja vendore me njësitë e saj nuk përfshihet tek asnjë prej këtyre pushteteve; Kuvendi nuk ka marrë ndonjë kompetencë dhe nuk ka penguar apo bllokuar Bashkinë apo ndonjë prej organeve të saj në përmbushjen e kompetencave të tyre; pavarësia e KRRT-së nuk ka natyrë kushtetuese; objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor është në përputhje me funksionin kushtetues të kontrollit parlamentar; hetimi i praktikave dhe procedurave në dhënien e lejeve të ndërtimit në KRRT-në e Bashkisë Tiranë, në konflikt interesi e në shkelje të ligjit, si dhe bllokimi i miratimit të planit rregullues të territorit të Bashkisë Tiranë, janë kompetencë e kontrollit parlamentar, sepse përbëjnë një çështje të veçantë, pasi përmbajnë në vetvete interesin publik; pretendimi i kërkuetit se, në bazë të ligjit për komisionet hetimore, Kuvendi nuk mund të ngrejë komisione hetimore gjatë 4 muajve të fundit para mbarimit të mandatit është i pabazuar, sepse komisioni hetimor është ngritur 10 ditë përpara mbarimit të afatit ligjor.

II

1. Lidhur me pretendimin për moslegjitimitimin e palës kërkuese.

Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka pretenduar se pala kërkuese nuk legjitimohet të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke arsyetuar, në thelb, se kërkuesi nuk është përfaqësues i njësisë së qeverisjes vendore dhe as i autorizuar nga organi përfaqësues i kësaj njësie, të cilët mund të jenë subjekte në konflikt ose subjekte të cenuara drejtpërdrejt nga konflikti dhe, se në këtë rast, nuk është krijuar dhe nuk mund të ekzistojë një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vëren se, bazuar në nenin 131, germa “ç” të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore). Veç këtyre, në mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve mund të përfshihen edhe mosmarrëveshje të tjera, siç janë ato që mund të lindin midis organeve apo subjekteve që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të shprehur në njërin apo tjetrin pushtet, siç janë Presidenti, Gjykata Kushtetuese, prokuroria ose organe të tjera kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese rithekson se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “*normativ*”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “*individual*”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 21.12.2006; nr.26, datë 4.12.2006*).

Gjykata Kushtetuese vëren se, përveçse në hipotezat e mësipërme, bazuar në doktrinën kushtetuese, konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon që sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i

tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre.

Dispozita kushtetuese e nenit 131, germa “ç” është detajuar në nenin 54/3 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, nr. 8577, datë 10.02.2000, i cili parashikon se kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata Kushtetuese vendos, sipas nenit 56 të ligjit të sipërpërmendur, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton gjithashtu edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

Një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa i takon funksioneve të nivelit kushtetues (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 4.05.2007; nr.29, datë 21.12.2006*).

Gjykata Kushtetuese thekson se vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues që konsiston, midis të tjerave, në ushtrimin nga organet e qeverisjes vendore të funksioneve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror (neni 113 i Kushtetutës), në ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113, shkronja “b”, “c”, “ç”, të Kushtetutës) (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 21.12.2006*).

Në jurisprudencën kushtetuese, për çështje që kanë pasur për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore Gjykata ka konkluduar se planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor “funksionet e veta”, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 21.12.2006*).

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor dhe planin paraprak të hetimit të miratuar nga ky komision vlerëson se, në rastin në shqyrtim, janë të pranishme të gjitha elementet e një mosmarrëveshjeje kompetencash. Konkretisht, Kuvendi si pushtet ligjvënës, bazuar në nenin 77 të Kushtetutës, ka marrë vendimin nr. 249, me të cilin ka konsideruar veten kompetent për të kontrolluar e vlerësuar ligjshmërinë e aktiviteteve të Bashkisë së Tiranës në fushën e planifikimit urban dhe të lejeve të ndërtimit për periudhën janar 2007 – prill 2009. Bashkia e Tiranës, nëpërmjet kryetarit të saj, si organ ekzekutiv i qeverisjes vendore dhe një ndër subjektet e parashikuara nga neni 134, pika 1, germa “e” i Kushtetutës, por më tepër si “subjekt në konflikt”, duke iu referuar parimit të decentralizimit të pushtetit dhe atij të autonomisë vendore, sanksionuar në nenin 13 të Kushtetutës, pretendon se çështjet objekt hetimi të këtij komisioni janë kompetencë vetëm e organeve të qeverisjes vendore dhe se asnjë institucion apo organ tjetër nuk mund të marrë vendime në lidhje me to.

Përsa i përket legjitimitetit formal dhe procedural Gjykata Kushtetuese vlerëson se është pikërisht kryetari i bashkisë dhe jo këshilli bashkiak organi i qeverisjes vendore që justifikon në këtë rast interesin e tij për ta vënë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptim të nenit 134, pika 1, germa “e” të Kushtetutës. Bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Kryetari i Bashkisë ushtron të gjitha kompetencat që ligji i ka njohur bashkisë në fushën e planifikimit urban, si dhe kryen *ex officio* detyrën e kryetarit të KRRT-së, bazuar në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” – në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës.

III

Përpara se të shprehet në lidhje me themelin e çështjes, Gjykata Kushtetuese do të ndalet në funksionet dhe kompetencat kushtetuese të Kuvendit të Shqipërisë dhe në veçanti, në kompetencat e komisioneve hetimore.

1. Funksioni i kontrollit parlamentar dhe statusi i një komisioni hetimor.

Gjykata, në shqyrtimin e funksionit kushtetues të Kuvendit dhe rolin e komisionit parlamentar hetimor në këtë drejtim rithekson se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk i njeh epërsi një pushteti ose organi kushtetues në raport me pushtetet e tjera të shtetit. Demokracia kushtetuese, e vendosur me këtë Kushtetutë, bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, asnjë organ apo institucion, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. Kuvendi është një nga organet e autoritetit të shtetit. Kompetencat e tij, dhe për pasojë sfera e veprimtarisë së tij, janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje. Brenda limiteve të parashikuara në Kushtetutë Kuvendi gëzon një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 20.05.2008*).

Gjykata Kushtetuese rithekson se në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese Kuvendi kryen funksionet klasike të këtij institucioni në një shtet të së drejtës, që janë: miratimi i ligjeve (funksioni legjislativ), ushtrimi i kontrollit parlamentar, kryesisht ndaj pushtetit ekzekutiv, por dhe ndaj institucioneve të tjera (funksioni i kontrollit), emërimi dhe shkarkimi i krerëve të institucioneve kryesore kushtetuese (funksioni emërues), miratimi i Buxhetit të Shtetit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij (funksioni financiar). Në këtë drejtim, kontrolli parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive, sipas rasteve konkrete. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kontrolli, krijohet mundësia e kontrollit publik të funksionimit të administratës shtetërore (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.05.2003*).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se duke pasur parasysh statusin kushtetues të Kuvendit/Parlamentit, si organ përfaqësues i popullit, mund të konkludohet se në parim, kontrolli parlamentar i referohet gjithë aktivitetit shtetëror dhe të gjitha autoriteteve publike. Por një kompetencë e tillë nuk e transformon Kuvendin në një superorgan të pushtetit të shtetit. Bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, demokracia parlamentare nuk është një sistem ku parlamenti mund të ushtrojë kontroll mbi çdo vendim të institucioneve, të nisë procedura për të vendosur sanksione ndaj tyre, apo të marrë vendime në emër të institucioneve që e kanë një kompetencë të tillë. Një interpretim ndryshe i kësaj kompetence kontrolli që i njihet Kuvendit, do të çonte në mohimin e parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se, në aspektin kushtetues, komisioni hetimor është një nga instrumentet e kontrollit me anë të të cilit Kuvendi ushtron dhe perfeksionon pushtetin e tij legjislativ. Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është njohja dhe verifikimi i një fenomeni, i një ngjarjeje, apo i një veprimtarie, me synimin për të nxjerrë përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit, apo korigjimit të ligjeve të veçanta, si dhe për të nxjerrë përgjegjësinë mbi mënyrën e qeverisjes. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me jurisprudencën e konsoliduar të saj, rithekson se kontrolli parlamentar nuk mund të përdoret tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.05.2003*).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se Kushtetuta nuk përmban një autorizim të përgjithshëm për Kuvendin që, nëpërmjet një komisioni hetimor, të ekzaminojë çdo çështje. Për pasojë, në aspektin kushtetues është e lejueshme që Kuvendi ta përdorë këtë mjet kontrolli kurdo që vlerëson se duhet të hetohet një *çështje e veçantë*, në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës. Duhet të vihet në dukje gjithashtu se, një hetim i tillë nuk mund të zëvendësojë apo të dublojë prerogativat e organeve të tjera të pavarura. Për zhvillimin e një hetimi parlamentar duhet të përmbushen të paktën këto kushte kryesore: hetimi i çështjes duhet të synojë sigurimin e një informacioni që është në funksion të procesit ligjvënës, apo që u shërben funksioneve të tjera për të cilat është i autorizuar Kuvendi dhe, objekti i hetimit duhet të përqëndrohet në një çështje të veçantë (duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështjeje të një interesi të veçantë publik, për të cilën është i nevojshëm ky hetim) (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 4.05.2007*).

Lidhur me statusin kushtetues të komisioneve hetimore parlamentare, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se, nga pikëpamja kushtetuese, komisionet hetimore dallojnë nga komisionet e tjera parlamentare, d.m.th. nga komisionet e përhershme apo të posaçme, organe që funksionojnë brenda strukturave të Kuvendit. Në dallim nga këto të fundit, disa aspekte të procedurës së formimit, si p.sh. subjektet inicuese të hetimit parlamentar, objekti i përgjithshëm i hetimit, efekti juridik i përfundimeve të hetimit, janë rregulluar nga vetë kuadri kushtetues (neni 77, pika 2 dhe 3 i Kushtetutës). Përveç kuadrit kushtetues, lidhur me komisionet hetimore parlamentare ka edhe një kuadër ligjor të caktuar, siç është ligji nr.8891, datë 2.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”. Sipas këtij ligji, komisioni hetimor ka të drejtë të mbledhë të dhëna që mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, administron dokumente zyrtare, si dhe të dhëna të tjera, thërret dëshmitarë, thërret ekspertë, thërret titullarë institucionesh për pyetje, si dhe kërkon nga ata informacione ose dokumente zyrtare.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese thekson se për natyrën hetimore të një komisioni të tillë nuk mjafton vetëm emërtimi i tij si “Komision hetimor”, por ai duhet të ketë karakteristikat që burojnë nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, të cilat përcaktojnë kushtet për ngritjen e tij, si dhe sferën dhe natyrën e veprimtarisë së këtij komisioni (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 20.05.2008*).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se Kuvendi, kur cakton një komision hetimor, duhet të respektojë parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe limitet kushtetuese të kontrollit parlamentar, të cilat nuk lejojnë që ky kontroll të ushtrohet për çdo çështje dhe për çdo organ. Nga ana tjetër, objekti i kontrollit parlamentar duhet të jetë i tillë, që të mos çojë në shkeljen e rregullimeve kushtetuese që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me organet e tjera.

2. Koncepti çështje e veçantë në aspektin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese rithekson se, në aspektin kushtetues, komisionet hetimore mund të ngrihen për të shqyrtuar një çështje të veçantë (neni 77 i Kushtetutës). Për pasojë, për korrektësinë e ngritjes së një komisioni hetimor është e rëndësishme përcaktimi i “*çështjes*” që mund të jetë objekt i hetimit parlamentar.

Në opinionin e Gjykatës Kushtetuese, “*një çështje*” që në aspektin kushtetues mund të nënshtrohet hetimit parlamentar, përbëhet nga fakte apo rrethana, të cilat përfshihen në objektin e veprimtarisë së Kuvendit dhe për të cilat ekziston një mosmarrëveshje. Në këtë kuptim, çështja duhet të jetë manifestuar përpara marrjes së një vendimi përkatës nga ana e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor. Për pasojë, duhet theksuar se komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt një çështje në kuptimin kushtetues dhe jo për të verifikuar nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 4.05.2007*).

Përveç sa sipër, duhet të theksohet se në aspektin kushtetues jo çdo “*çështje*”, pavarësisht rëndësisë së saj, mund të jetë objekt i hetimit parlamentar, por vetëm ato çështje që përmbushin kriterin e veçantisë. Në opinionin e Gjykatës Kushtetuese, në parim “*çështje e veçantë*”, objekt i hetimit parlamentar, është një çështje me rëndësi të veçantë shtetërore/publike. Lista e këtyre çështjeve me rëndësi/interes të madh shtetëror/publik nuk mund të jetë shterruese, por duhet të përcaktohet rast pas rasti (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.05.2003*).

Gjykata Kushtetuese shton gjithashtu, se objekti i hetimit, i argumentuar qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme në kërkesë, duhet të përmbajë fakte të përcaktueshme ose kompleks faktesh, të cilat të tregojnë qartë se për çfarë po hetohet. Në këtë mënyrë, objekti i hetimit evidenton dhe çështjen e veçantë. Të gjitha ato çështje që përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që përmbajnë në vetvete një interes të veçantë shtetëror/publik, përbëjnë një çështje të veçantë në kuptimin kushtetues (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 20.05.2008; nr.18, datë 14.05.2003*).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në parim, kur ka një çështje të veçantë, domethënë një çështje të një rëndësie të veçantë publike, Kushtetuta nuk ndalon Kuvendin që, në funksion të veprimtarisë së tij ligjvënëse, të formojë komisione hetimi, të tilla që mund të ngarkohen me hetimin e aktivitetit të shtetit ose institucioneve të qeverisjes vendore, pra për mënyrën si kryejnë institucionet përkatëse shtetërore ose vendore funksionet e tyre të përcaktuara në Kushtetutë dhe

ligje. Megjithatë është gjithmonë e nevojshme të përmbushet kriteri kushtetues që çështja për të cilën zhvillohet hetimi parlamentar, duhet të jetë e një rëndësie të veçantë publike. Në rast të kundërt, hetimi parlamentar, në aspektin kushtetues, është i pajustificuar.

3. *Veçantia e çështjes objekt hetimi i komisionit të ngritur me vendimin nr. 249 të Kuvendit të Shqipërisë.*

Gjykata Kushtetuese thekson se, kërkesa që çështja të jetë “*e veçantë*”, pra e një rëndësie të veçantë publike, përbën një parakusht të kushtetutshmërisë së veprimtarisë së një komisioni hetimor. Kjo pasi një komision hetimor është një organ procedural i pajisur, në një farë mase, me instrumente hetimi që janë karakteristike për organet e prokurorisë dhe ato gjyqësore dhe për pasojë, përdorimi i tepruar dhe i papërshtatshëm i tyre, mund të cenojë vlerat kushtetuese. Identifikimi i subjekteve të hetimit dhe objektit të veprimtarisë hetimore të komisionit parlamentar është kusht për të përcaktuar nëse duhet ose jo të ndërmerret një hetim i tillë parlamentar.

Në rastin në shqyrtim, shtrohet pyetja nëse përbën çështje të një rëndësie të veçantë shtetërore/publike çështja objekt hetimi parlamentar, e përcaktuar në bazë të vendimit të kundërshtuar të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese vëren se, sipas vendimit nr. 249, Kuvendi ka përcaktuar si objekt të punës të komisionit hetimor, hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës nga viti 2007 e në vijim. Është kërkesë kushtetuese që objekti i hetimit parlamentar të formulohet në mënyrë të qartë, sepse ai paragjykon ekzistencën e një çështjeje në kuptim të nenit 77, pika 2 të Kushtetutës. Analiza e vendimit të kundërshtuar provon se objekti i hetimit nuk specifikon çështjen e një rëndësie të veçantë shtetërore/publike. Për specifikimin e objektit të veprimtarisë së komisionit, Kuvendi ka përdorur nocione si “*hetimi i praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit*”, çka lind një dyshim thelbësor nëse objekti i kontrollit përfshin të gjitha lejet e ndërtimit të dhëna në këtë periudhë, kontrollin e të gjitha praktikave dhe procedurave për miratimin dhe dhënien e të gjitha lejeve të lëshuara nga KRRT-ja Tiranë (leje që kanë natyrën e akteve administrative).

Gjykata Kushtetuese vlerëson gjithashtu se vendimi që formulon objektin duhet të plotësojë kriterin e saktësisë dhe të mos-dyktuptimësisë. Në rastin në shqyrtim “*papërcaktueshmëria e çështjes*” është rrjedhojë e mënyrës me të cilën vendimi i kundërshtuar ka formuluar çështjet objekt hetimi. Formulimi i objektit të veprimtarisë së komisioneve hetimore në mënyrë të paqartë është i palejueshëm në një shtet demokratik të së drejtës, pasi përbën një kërcënim real për shkeljen e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe për një ndërhyrje të tepruar në sferën e kompetencave të organeve të tjera shtetërore. Për pasojë, në qoftë se objektivi i ngritjes së komisioneve hetimore nuk mund të arrihet për shkak të përcaktimit jokushtetues të detyrave të komisionit hetimor nga ana e parlamentit, kjo do të thotë se nuk është përmbushur një detyrim tjetër kushtetues, që ka të bëjë me funksionimin e organeve publike dhe konkretisht, me detyrimin për të siguruar kujdes dhe efikasitet në punën e organizmave publikë.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se përkufizimi i objektit të hetimit përbën hapin e parë nga ku do të përcaktohet edhe ecuria e hetimit parlamentar. Objekti i hetimit, i parashtruar në mënyrë të qartë e të saktë, duhet të përmbajë fakte ose tërësi faktesh, nga të cilët merr shkas hetimi parlamentar dhe shpjegon se çfarë hetohet. Veç kësaj, objekti i hetimit duhet të jetë i përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme, kusht ky që kërkohet për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, respektimin e të drejtave themelore, të parimit të ndarjes së pushteteve, si dhe kompetencave të kufizuara që disponon një komision hetimor (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 4.05.2007*). Duke analizuar nocionet që janë përdorur në vendimin e Kuvendit, ato rezultojnë të paqarta dhe kuptimi i tyre mund të specifikohet vetëm gjatë procesit të punës së komisionit. Një situatë e tillë, pra specifikimi i objektit të hetimit nga ana e komisionit hetimor, do të përbënte një nëndelegim nga ana e Kuvendit, çka është në kundërshtim me nenin 77, pika 2 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në rastin në shqyrtim, duke përcaktuar si objekt të hetimit shqyrtimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë Tiranë, nga viti 2007 e në vijim, Kuvendi e ka përcaktuar këtë objekt në mënyrë të përgjithshme, çka kërkon si pasojë një specifikim paraprak nga ana e komisionit hetimor. Kjo do të thotë se Kuvendi, *de facto*, i ka deleguar komisionit hetimor kompetencën e tij ekskluzive për specifikimin e veprimtarisë që do të

shqyrtohet nga ky komision.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese konkludon se, nga mënyra si është përcaktuar në vendimin e Kuvendit çështja objekt hetimi, nuk përmbushet kërkesa kushtetuese e “*veçantisë*” së çështjes, e cila duhet të jetë një veçori që duhet të rezultojë nga ky vendim.

4. Çështja e pranueshmërisë së kontrollit të ushtruar nga komisioni hetimor.

Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së çështjeve që lidhen me një hetim parlamentar, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.18, datë 14.05.2003, ka theksuar, ndërmjet të tjerash, parimet që duhen respektuar gjatë fazave të realizimit të hetimit, në çastin e formulimit të objektit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komisionit dhe në hartimin e konkluzioneve përfundimtare të hetimit.

Me vendimin nr. 249, datë 23.04.2009, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ngritjen e Komisionit Hetimor për “Shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës”. Duke iu referuar raportit të komisionit hetimor rezultojnë, se grupi i deputetëve ka kërkuar të hetohen praktikat dhe procedurat e dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë Tiranë, duke paraqitur si shkelje të rënda të ligjit këto fakte: 1) KRRT-ja Tiranë në të paktën dy data, 22.03.2009 dhe 12.04.2009, ka thirrur dy mbledhje dhe ka miratuar në to jo më pak se 6 projekte në njërin dhe 14 në tjetrën, të cilat i përkasin studios së njërit prej anëtarëve të KRRT-së, i cili ka votuar në to si anëtar, duke shkelur ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”; 2) KRRT-ja Tiranë, në të paktën dy mbledhjet e fundit gjatë vitit 2009, duke favorizuar hapur studiot e dy anëtarëve të KRRT-së Tiranë, ka shkelur rëndë ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; 3) janë dhënë leje ndërtimi abuzive dhe është bllokuar miratimi i planit të ri rregullues të Tiranës.

Ky komision ka parashikuar si çështje të themelit të hetimit, verifikimin nëse ka patur raste të dhënies së vendimeve të KRRT-së Tiranë në konflikt të hapur të interesit me anëtarët e saj, nëse janë këto raste sporadike apo janë raste që kanë kthyer këto veprime në fenomen të funksionimit të këtij institucioni dhe, nëse rastet e hetuara, përbëjnë veprime të kryera në kundërshtim me ligjin e konkurrencës dhe ligje të tjera të fushës së veprimtarisë së këtij komisioni.

Sipas raportit përfundimtar rezultojnë se gjatë punës së tij komisioni ka administruar dëshmitë e dy anëtarëve të KRRT-së Tiranë; dëshminë e Drejtoreshës së Agjencisë së Prokurimit Publik; si dhe kopje të relacioneve të mbledhjeve të KRRT-së të datave 17.04.2009, 13.05.2009, 26.02.2008, 7.06.2008, 27.12.2008, 22.03.2008, 12.04.2008. Mbi këto të dhëna dhe materiale, komisioni ka konkluduar se dy studiot ligjore që kanë marrë një numër shumë të madh lejesh ndërtimi, i përkasin dy anëtarëve të KRRT-së dhe ka vlerësuar se këto leje janë dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Kjo situatë është lejuar nga kryetari i bashkisë, i cili në bazë të këtij ligji është organi epror dhe duhet të ndërhynte për zgjidhjen e konfliktit të interesit. Po ashtu, sipas këtij raporti, vendimet e KRRT-së të datës 17.04.2009 janë marrë në kundërshtim me ligjin, sepse lejet e ndërtimit të dhëna në këtë mbledhje janë miratuar pa kuorumin e nevojshëm të përcaktuar nga neni 21 i ligjit për urbanistikën, jo më pak se pesë vota pro, dhe po ashtu në konflikt të hapur interesi. Në përfundim të hetimit të tij, komisioni hetimor ka konkluduar se: gjendja e konfliktit të interesit dhe paligjshmërisë nuk ka ekzistuar në mënyrë sporadike, por ka qenë e pranishme pothuajse në gjithë veprimtarinë e organit administrativ; gjendja e krijuar në KRRT-në e Bashkisë Tiranë, ku një apo dy studio marrin jo më pak se 55% të lejeve të ndërtimit dhe objekteve private dhe publike, bie në kundërshtim të hapur me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi shmang në mënyrë shumë të qartë të gjitha shoqëritë e tjera, duke krijuar një pozitë dominuese në treg; lejet e ndërtimit të dala në datën 17 prill 2009 janë akte administrative të pavlefshme; çështja duhet të i kalojë ILDKP-së dhe Avokaturës së Shtetit për trajtim më të hollësishëm.

Rezultojnë gjithashtu se me vendimin nr. 252, datë 15.05.2009, Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur të miratojë raportin përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës; t’i dërgojë raportin përfundimtar Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e çështjes penale për personat që eventualisht kanë abuzuar me detyrën dhe

funksionin publik; të konstatojë pavlefshmërinë e vendimeve të KRRT-së së Bashkisë së Tiranës të datës 17 prill 2009; të ngarkojë Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive që, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, të ndërmarrin masat ligjore në përputhje me nenin 40/6, shkronja “b” të ligjit nr.9367, datë 7.04.2005 “Për konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Sa sipër Gjykata Kushtetuese konstaton se, megjithëse plani i hetimit të komisionit hetimor rezulton të jetë më i zgjeruar, në fakt hetimi është përqendruar në shqyrtimin e veprimtarisë së KRRT-së përse i përket verifikimit të zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, gjatë marrjes së vendimeve në disa mbledhje të saj.

Ligji nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” ka si qëllim të tij garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta.

Sipas nenit 41 të këtij ligji, autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave janë Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (autoriteti qendror përgjegjës); autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike (eporët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik; drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik; institucionet eprore). Sipas nenit 42 të ligjit të sipërpërmendur, ILDKP-ja, midis të tjerave, bën monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të këtij ligji në tërësi, për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, si dhe respektimin e këtij ligji në raste të veçanta të konfliktit të interesave; verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast për rast të interesave, si dhe të ndalimeve e kufizimeve të interesave të përcaktuara në ligj, me kërkesë të institucionit publik a eprore ose, kur e gjykon të nevojshme, edhe me nismën e tij; vendos masa administrative ndëshkuese në kompetencë të tij, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Duket qartë se ligji i ka dhënë kompetenca të gjera dhe të mjaftueshme ILDKP-së, si institucioni që merr masat dhe verifikon rast pas rasti konfliktin e interesit në vendimmarrjen publike.

Gjykata Kushtetuese rithekson se funksioni kontrollues i Kuvendit nuk mund të qëndrojë jashtë natyrës së tij ligjvënëse. Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është për të njohur dhe verifikuar në thellësi një fenomen, një ngjarje, një veprimtari, me synimin që, në përputhje me realitetin, të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korigjimit të ligjeve të veçanta (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.05.2003*). Komisioni hetimor, duke hetuar një fushë të caktuar, brenda kompetencave që përfshihen në përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit, mund të arrijë të gjejë të dhëna të cilat përbëjnë shkak për t’u vlerësuar nga ana e tij, por pa hyrë në sferën e kompetencave të organeve të tjera (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 20.05.2008; nr.18, datë 14.05.2003*).

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se në rastin në shqyrtim, bazuar në veprimtarinë e komisionit hetimor, objekt hetimi ka qenë vlerësimi i “*gjendjes së konfliktit të interesave të disa anëtarëve të KRRT-së Tiranë*”, pra vlerësimi i mënyrës së zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave. Megjithatë, në rastin konkret komisioni ka hetuar aktivitetin e personave të veçantë të specifikuar në raport, dhe jo modelin e funksionimit të këtij organi. Duke qenë e tillë, kjo çështje mund t’i besohet një komisioni të zakonshëm (që nuk ka statusin e një komisioni hetimor) të Parlamentit, apo një institucioni të specializuar si ILDKP-ja, që u përmend më sipër, por jo një komisioni hetimor.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson se përfshirja e një komisioni hetimor në një objektiv që mund të arrihet me mjete të tjera, çon në cenimin e parimit të racionalitetit dhe proporcionalitetit në veprimtarinë e autoritetit publik.

Gjykata Kushtetuese vëren gjithashtu, se nga konkluzionet e komisionit hetimor rezultojnë se veprimtaria e tij nuk është përqendruar vetëm në verifikimin e fenomenit dhe ngritjen e problemeve. Komisioni ka vendosur të konstatojë pavlefshmërinë e vendimeve të KRRT-së Tiranë të datës 17

prill 2009 (konkluzione që janë miratuar edhe nga Kuvendi i Shqipërisë).

Në këtë drejtim Gjykata Kushtetuese thekson se formulimi i mendimit dhe pikëpamjes së Kuvendit në lidhje me konkluzionin e komisionit hetimor, nuk mund të interpretohet si një kualifikim ligjor i veprimeve që komisioni ka hetuar, i vendimit të marrë prej tij mbi çështjet që ishte ngarkuar të hetonte dhe i rrethanave të tjera të sqaruara prej tij. Kuvendi, pasi vendos nëse do miratojë ose jo konkluzionet e komisionit hetimor, nuk merr vendim në lidhje me përputhjen e veprimeve të tilla, vendimeve dhe rrethanave me aktet ligjore, çka është detyruese për institucionet e tjera si prokuroria dhe gjykata, por ai thjesht formulon vlerësimin dhe pikëpamjen e tij në lidhje me konkluzionet e komisionit.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, duke konstatuar pavlefshmërinë e vendimeve të KRRT-së Tiranë të datës 17 prill 2009, Kuvendi i Shqipërisë ka tejkaluar kompetencat e tij.

Në konkluzion të shqyrtimit të saj, Gjykata Kushtetuese vlerëson se objekti i hetimit të komisionit hetimor, i ngritur me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 249, datë 23.04.2009 “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës”, nuk ka respektuar kriteret e sanksionuara në nenin 77 të Kushtetutës dhe se objekti i veprimtarisë së tij nuk përputhet me funksionin dhe qëllimet e kontrollit parlamentar. Në këto kushte, nga mënyra se si është përcaktuar objekti i hetimit parlamentar në vendimin e Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor, me hetimin e kryer nga ana e komisionit hetimor, si dhe me konstatimin si të paligjshëm të vendimeve të KRRT-së nga ana e këtij komisioni, është shkaktuar një konflikt kompetencash, duke sjellë si pasojë pengimin e ushtrimit të kompetencave të veta nga ana e kërkuesit Bashkia Tiranë.

* * *

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se ngritja e këtij komisioni hetimor është në kundërshtim edhe me nenin 4/6 të ligjit nr.8891, datë 2.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i cili parashikon se: “Komisionet hetimore nuk mund të ngrihen gjatë 4 muajve para mbarimit të mandatit të Kuvendit”. Kërkuesi arsyeton se ky komision është ngritur në kundërshtim me ligjin, duke iu referuar mbylljes së legjislaturës ose shpërndarjes së Kuvendit, që në përputhje me nenin 9/2 të Kodit Zgjedhor, bëhet jo më shpejt se 45 ditë para datës së caktuar për zgjedhjet dhe jo më vonë se 30 ditë para kësaj date dhe duke marrë si pikë referimi datën e zgjedhjeve të përgjithshme, 28 qershor 2009.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se parashtrimin e këtij pretendimi pala kërkuesi nuk e ngriti dot në nivel kushtetues dhe për pasojë ai nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, germa “ç” dhe 134, pika 1, germa “e” të Kushtetutës, si dhe neneve 56, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke shfuqizuar vendimin nr. 249, datë 24.04.2009 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor” dhe vendimin nr. 252, datë 15.05.2009 “Për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

I. Lidhur me legjitimimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (*ratione personae*).

1. Çështja e legjitimitit të subjekteve të ndryshme për të iniciuar një gjykim kushtetues ka qenë dhe mbetet një çështje e debatuar gjerësisht si në aspektin teorik ashtu dhe atë praktik.

Gjykata, mbështetur në nenin 134, pika 1, germa “e” dhe 2 të Kushtetutës edhe më parë ka legjitimuar Kryetarin e Bashkisë së Tiranës për ta vënë në lëvizje këtë gjykatë duke e konsideruar Bashkinë si pjesë të organeve të qeverisjes vendore, dhe kryetarin si përfaqësues të saj, kur ka provuar rast pas rasti se janë cenuar interesat e qeverisjes vendore.

2. Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr.249, datë 23.04.2009, ka ngritur një komision hetimor për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit nga Këshilli i Rregullimit të Territorit (në vijim KRRT) pranë Bashkisë së Tiranës. Kryetari i Bashkisë duke pretenduar se objekti i veprimtarisë së komisionit është antikushtetues, i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata) të zgjidhë mosmarrëveshjen e kompetencës të krijuar, sipas tij, midis pushtetit legjislativ dhe qeverisjes vendore (Bashkisë së Tiranës). Për t’i dhënë përgjigje çështjes së legjitimitit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për ta vënë në lëvizje këtë Gjykatë, *ratione personae*, para saj shtroheshin për zgjidhje këto probleme; së pari, cili është statusi juridik i KRRT-së dhe së dyti, cili është statusi i Kryetarit të Bashkisë në raport me këtë institucion.

3. Sipas nenit 16 të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, KRRT-ja funksionon si organ vendimmarrës pranë këshillave të qarqeve, Bashkisë së Tiranës dhe bashkive që janë të qyteteve të kategorisë së parë...” ndërsa sipas nenit 19, KRRT-ja e Bashkisë së Tiranës përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët janë Kryetari i Bashkisë së Tiranës, si kryetar, 3 anëtarë, me propozimin e shumicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, 3 anëtarë me propozimin e pakicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, 1 anëtar, përfaqësues i ministrit përgjegjës për planifikimin urban dhe një anëtar që zgjidhet me 3/5 e votave të të gjithë Këshillit Bashkiak të Tiranës. Një mënyrë përfaqësimi e tillë tregon kujdesin e ligjvënësit, për shkak të rëndësisë të veçantë që ka vendimmarrja e këtij organi në çështjet e planifikimit urban.

4. Në këto dispozita tërheqin vëmendjen disa probleme që na ndihmojnë për t’i dhënë përgjigje çështjes të legjitimitit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për të iniciuar një gjykim kushtetues lidhur me vendimmarrjen e KKRT. Së pari, KKRT-ja është një organ kolegjal përfaqësues gjithpërfshirës ku Kryetari i saj ndonëse është titullari i bashkisë, në vendimmarrje ka të drejtën e një vote njëlloj si të gjithë anëtarët e tjerë, së dyti, shumica e anëtarëve të KKRT-së janë përfaqësues të Këshillit Bashkiak të Tiranës (7 prej tyre) ndërsa një anëtar është përfaqësues i ministrit përgjegjës për planifikimin urban. Shumica, në zgjidhjen e çështjes së legjitimitit, *ratione personae*, duhet të konsideronte këto fakte të rëndësishme që lidhen jo vetëm me respektin ndaj institucioneve që përfaqësojnë anëtarët e KKRT-së, por në tërësi edhe me integritetin dhe legjitimitetin e funksionimit dhe vendimmarrjes së organeve kolegjiale në një shtet të së drejtës, ku drejtuesi përveç aspektit organizativ nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë tagër që të veprojnë në emër dhe për llogari të organit që përfaqëson pa qenë i autorizuar prej ligjit ose prej vetë organit kolegjal. Përfaqësuesi i kërkuesit pranoi para Gjykatës se Kryetari i Bashkisë nuk ishte pajisur me akt përfaqësimi nga KKRT-ja për të mbrojtur interesat e saj dhe se sipas tij një autorizim i tillë ishte i panevojshëm. Në një shtet demokratik, mendojmë se janë të papranueshme praktikat e anashkalimit të organeve kolegjiale nga drejtuesit e tyre pa pasur një akt delegimi nga ligji apo përfaqësuesit e organit. Janë këto arsyet për të cilat mendojmë se shumica ka gabuar duke legjitimuar, *ratione personae*, Kryetarin e Bashkisë së Tiranës për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese lidhur me vendimmarrjen e KKRT-së.

5. Kërkuesi ka pretenduar se ngritja e komisionit hetimor parlamentar për të hetuar procedurat e dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës ka krijuar një mosmarrëveshje kompetencash midis pushtetit qendror, në rastin konkret pushteti legjislativ nga njëra anë dhe qeverisjes vendore nga ana tjetër duke kërkuar zgjidhjen e saj.

II. Legjitimimi i kërkuesit, *ratione materiae*, dhe kuptimi kushtetues i konfliktit të pushteteve.

6. Sipas doktrinës kushtetuese, që të kemi konflikt kompetencash midis pushteteve ndër të tjera duhet të ekzistojë edhe një kusht sipas të cilit konflikti të ketë lindur për përcaktimin e sferave të kompetencave të përcaktuara nga normat kushtetuese e ligjore për pushtete të ndryshme që do të thotë se ushtrimi i kompetencave nga njëri apo tjetri organ pushteti është i diskutueshëm ose dy pushtete të ndryshëm pretendojnë si të tyre ushtrimin e të njëjtës kompetencë.

7. Para së gjithash organi që pretendon se i janë marrë kompetenca apo janë vënë në diskutim nga një organ tjetër duhet t'i provojë ato para Gjykatës. Po t'i referohemi pretendimeve të kërkuesit nuk ka asnjë fakt që të vërtetojë se diçka e tillë ka ndodhur. I vetmi pretendim i kërkuesit është se Kuvendi i Shqipërisë nuk legjitimohet të shqyrtojë vendimet e marra nga KKRT-ja për dhënien e lejeve të ndërtimit, sepse në këtë mënyrë ka ndërhyrë në kompetencat e një pushtetit tjetër, që i përket Bashkisë së Tiranës. Sipas doktrinës kushtetuese, do të ndodheshim para një konflikti kompetencash, në qoftë se Kuvendi nëpërmjet një akti legjislativ të marrë prej tij do të cenonte ose zvogëlonte sferën e kompetencave kushtetuese të qeverisjes vendore. Kërkuesi nuk paraqiti para Gjykatës asnjë pretendim të kësaj natyre.

8. Atëherë le t'i kthehemi argumenteve të shumicës lidhur me pranimin e kërkesës. Shumica duke iu referuar vendimmarrjes së mëparshme të kësaj Gjykate arsyeton me të drejtë se një mosmarrëveshje kompetence duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njej Kushtetuta, që kompetenca kushtetuese të parashikohet si e tillë dhe që gjykimi në Gjykatën Kushtetuese të përqendrohet në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Cila është mosmarrëveshja në rastin konkret? Shumica argumenton se për çështje të ngjashme të shqyrtuara më parë (*shih vendimin nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata ka konkluduar se planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor “funksionet e veta”, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre. Dhe më tej, shumica argumenton se duke parë objektin e hetimit dhe planin paraprak të komisionit hetimor, janë të pranishëm të gjitha elementet e një mosmarrëveshje kompetencash. Pavarësisht referimit në jurisprudencën e Gjykatës, mendoj se shumica gabon kur arsyeton se “planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore”. Mjafton t'i hidhet një vështrim dispozitave të ndryshme të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar (shih nenin 10, pika 3, g) dhe ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar (shih nenet 1, 2, 4, 9, 12 etj.) për të kuptuar se ky konkluzion kategorik i Gjykatës është i gabuar. Planifikimi urban është një çështje komplekse që përfshin gjithë territorin e vendit dhe ku ka një integrim si vertikal ashtu dhe horizontal të kompetencave ligjore midis organeve lokale të pushtetit dhe atyre qendrore. Kështu në nenin 2 të ligjit “Për urbanistikën” thuhet ndër të tjera se urbanistika shpreh dhe përcakton rregullat e përgjithshme të vendosjes dhe të arkitekturës së ndërtimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ku mbahen parasysh zhvillimi ekonomik dhe social, aktual dhe perspektiv i vendit në nivel kombëtar dhe lokal, mbrojtja e vendit, mbrojtja e mjedisit etj. Ndërsa në nenin 9 të të njëjtit ligj thuhet se KRRTRSH-ja miraton ndër të tjera dhe studimet rajonale. Më tej, neni 12 i këtij ligji i jep të drejtë ministrisë përkatëse që ndjek veprimtarinë e planifikimit të territorit të ushtrojë kontroll në organet e pushtetit vendor që merren me planifikimin e territorit etj. Shumica gabon kur pranon shqyrtimin e kërkesës edhe për faktin se nuk ka asnjë të dhënë që të vërtetojë se ligjvënësi, nëpërmjet një ligji apo vendimi të ketë zvogëluar sferën e kompetencave të pushtetit vendor në fushën e planifikimit urban, konkretisht në kompetencat e “Bashkisë” në dhënien e lejeve të ndërtimit. Gjithashtu nuk rezulton asnjë e dhënë që ligjvënësi t'ia ketë deleguar këto kompetenca pushtetit ekzekutiv apo vetes. Nisur nga sa sipër është tepër i diskutueshëm problemi nëse KKRT-ja është pjesë ekskluzive e qeverisjes vendore në kuptimin që vendimmarrja e saj të gëzojë të njëjtën mbrojtje kushtetuese me vendimmarrjen e pushtetit vendor apo Bashkisë së Tiranës, si pushtet i pavarur.

III. Lidhur me kuptimin kushtetues të kontrollit parlamentar dhe statusin e një komisioni hetimor.

9. Shumica, duke iu kthyer jurisprudencës të kësaj Gjykate në vite, është përpjekur të japë disa konsiderata lidhur me kufijtë e kontrollit parlamentar, posaçërisht edhe të komisioneve hetimore parlamentare, në funksion të arritjes së një përfundimi lidhur me themelin e çështjes. Mendoj se argumentet e shumicës në këtë pjesë të vendimit janë kontradiktore dhe nuk përlligjin vendimmarrjen e saj në çështjen në fjalë. Kështu, me të drejtë ajo rithekson se Kuvendi kryen, ndër të tjera, edhe funksione të tilla si miratimi i ligjeve (funksioni legjislativ) apo ushtrimi i kontrollit parlamentar, kryesisht ndaj pushtetit ekzekutiv, por dhe ndaj institucioneve të tjera (funksioni i kontrollit). Dhe më tej ajo pranon, gjithashtu me të drejtë, se kontrolli parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar (vini re) dhe për të realizuar mbikëqyrje për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik (vini re), me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë dhe nxjerrjen e përgjegjësive, sipas rasteve konkrete. Nisur nga këto pohime të shumicës, lind pyetja: A mund t'i kufizohet Kuvendit e drejta e informimit lidhur me veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore në fushën e zbatimit të ligjeve kur një të drejtë të tillë, sipas nenit 23 të Kushtetutës, e gëzon çdo qytetar i këtij vendi? A mundet Kuvendi të kufizohet në të drejtën e tij për të verifikuar zbatimin e ligjeve me qëllim marrjen e masave për përmirësimin dhe përsosjen e tyre? A mundet Kuvendit t'i kufizohet e drejta që në funksion të kontrollit të zbatimit të ligjeve të kërkojë nga institucionet përkatëse kompetente marrjen e masave dhe vënien e personave para përgjegjësisë për shkeljen e ligjit dhe Kushtetutës? Këto pyetje shumica duhet t'i konsideronte edhe në funksion të zgjidhjes së çështjes të legjitimitit, *ratione materiae*.

Në një republikë parlamentare ku të gjitha pushtetet burojnë nga parlamenti, këtotribute janë në natyrën e tij kushtetuese dhe nuk mund t'ia kufizojë askush.

10. Nga ana tjetër kontrolli parlamentar nuk mund të jetë i pakufizuar dhe në këtë përfundim pajtohem me shumicën, por jo me argumentet e saj në mënyrë të veçantë lidhur me çështjen objekt shqyrtimi (shih më poshtë). Kontrolli hetimor parlamentar është i detyruar të respektojë parimin e ndarjes së pushteteve dhe në këtë kuptim i ndalohe të vërë në diskutim vendimmarrjen e pushteteve të tjera qoftë nëpërmjet rivlerësimit, ndryshimit apo shfuqizimit të tyre ashtu dhe nëpërmjet imponimit të zgjidhjeve.

IV. Lidhur me konceptin kushtetues “çështje e veçantë”.

11. Gjykata Kushtetuese ka një jurisprudencë të pasur për interpretimin kushtetues të konceptit “çështje e veçantë”. Me të drejtë Gjykata ka theksuar se çështjet e hetimit të trajtuara në aspektin e kontrollit dhe zbatimit të ligjit, të njohjes dhe verifikimit të një ngjarjeje, a veprimtarie që nxisin iniciativa për propozime dhe miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetin, nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, përfshihen në konceptin kushtetues “çështje e veçantë” (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.05.2003. Përmbledhje vendimesh, viti 2003, fq. 84*).

12. Mendoj se koncepti “çështje e veçantë” përfshin në vetvete dy aspekte, aspektin interpretativ që është atribut i Gjykatës Kushtetuese, si institucioni i vetëm që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe aspektin çmues apo vlerësues nëse një çështje është e tillë që të justifikojë ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Lidhur me aspektin e parë, siç u përmend dhe më lart Gjykata është përpjekur në jurisprudencën e saj të japë kuptimin kushtetues të një “çështjeje të veçantë”, duke theksuar ndër të tjera se çështja duhet të jetë me rëndësi shtetërore apo publike dhe në këtë kuptim lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shtetërore, por duhet të përcaktohet rast pas rasti. Lidhur me vlerësimin e një çështjeje nëse është e veçantë, në kuptimin kushtetues, e tillë që të justifikojë ngritjen e një komisioni hetimor, mendoj se është në domenin e Kuvendit, në diskrecionin e tij dhe të askujt tjetër, përfshi dhe Gjykatën Kushtetuese. Asnjë organ tjetër, më shumë se organi legjislativ, nuk është në gjendje të çmojë dhe të vlerësojë nëse një çështje është me interes të veçantë shtetëror apo publik. Shumica gabon kur konkludon se “nga mënyra si është përcaktuar në vendimin e Kuvendit çështja objekt hetimi, nuk përmbushet kërkesa e “veçantisë së çështjes”. Në këtë rast shumica ka tejkaluar kompetencat e veta, duke marrë targa që nuk i përkasin gjykimit kushtetues dhe duke e kthyer veten në një gjykatë fakti.

V. Lidhur me themelin e kërkesës.

13. Shumica shprehet në vendim se megjithëse plani i hetimit të komisionit hetimor rezulton të jetë më i zgjeruar, në fakt hetimi është përqendruar në shqyrtimin e veprimtarisë së KRRT-së përsa i përket verifikimit të zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, nr.9367, datë 7.04.2005. Duke iu referuar objektit të këtij ligji, shumica citon se ai ka për qëllim garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut dhe besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta. Këto citime të marra nga vendimi i shumicës dhe që i referohen ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, janë në kontradiktë me përfundimin e nxjerrë prej saj më lart se çështja që përbën objektin e hetimit të komisionit hetimor parlamentar, nuk është me interes publik në kuptimin kushtetues. Respektimi i ligjeve nga organet shtetërore, por dhe nga individët është një nga çështjet dhe problemet themelore për funksionimin e shtetit ligjor. Ky problem përbën ende një shqetësim serioz të shoqërisë dhe institucioneve shqiptare, dhe për këtë arsye roli i Kuvendit si organ ligjvënës dhe nëpërmjet kontrollit parlamentar është i pazëvendësueshëm.

14. Më poshtë, shumica duke iu referuar nenit 41 të ligjit për konfliktin e interesave përpiqet të argumentojë se autoriteti përgjegjës për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (më poshtë ILDKP) dhe sipas saj kontrolli i zbatimit të ligjit të sipërpërmendur nga komisioni hetimor parlamentar çon në “cenimin e parimit të racionalitetit dhe proporcionalitetit në veprimtarinë e autoritetit publik”, pa dhënë asnjë shpjegim se çfarë përfaqëson ky parim, çfarë standardi kushtetues prek, cila është lidhja e tij me çështjen objekt kontrolli kushtetues. Duket sikur shumica e gjen konfliktin e kompetencave jo midis veprimtarisë së organeve të qeverisjes vendore dhe pushtetit legjislativ, por midis këtij të fundit dhe ILDKP-së gjë që nuk ka lidhje me objektin e gjykimit. Nga ana tjetër, siç u trajtua dhe më lart, asgjë nuk e pengon Kuvendin që nëpërmjet kontrollit hetimor parlamentar për një çështje të veçantë të hetojë dhe të nxjerrë përfundime për efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë funksionale të organeve të kontrollit, ku bën pjesë edhe ILDKP-ja.

15. E vetmja çështje që ka krijuar keqkuptime lidhur me objektin dhe kufijtë e kontrollit hetimor parlamentar në rastin në fjalë është shprehja e përdorur në konkluzionet e komisionit hetimor parlamentar se komisioni ka vendosur “të konstatojë pavlefshmërinë e vendimeve të KRRT-së”, të cilës shumica i kushton një vëmendje të veçantë. Është e lehtë të konstatohet se shprehja në fjalë është një deklaratim formal që nuk sjell asnjë pasojë juridike pasi është fakt i njohur se shpallja e një akti administrativ si absolutisht të pavlefshëm është atribut vetëm i gjykatës.

Për këto arsye mendojmë se vendimi i shumicës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë duke shfuqizuar vendimin nr.249, datë 24.04.2009 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor” dhe vendimit nr.252, datë 15.05.2009 “Për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit hetimor”, është kontradiktore, i paargumentuar dhe për rrjedhojë i pambështetur në argumente kushtetuese¹.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Admir Thanza, Xhezair Zaganjori.

¹ Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese Xhezair Zaganjori dhe Admir Thanza janë shprehur *pro* përsa i përket çështjes së legjitimitetit të subjektit kërkues Bashkia e Tiranës.

MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës sa i përket legjitimitit të kërkuarit Bashkia Tiranë për si vijon:

1. Çështjen e legjitimitit të kërkuarit Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Në funksion të legjitimitit *ratione personae*, kërkuari duhet të jetë një nga subjektet e përcaktuara në nenin 134 të Kushtetutës, konkretisht në paragrafin “1”, nënparagrafi “e” të këtij neni, në të cilin sanksionohet se “*Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesën të ... organeve të qeverisjes vendore*”.

2. Për të vlerësuar nëse Bashkia Tiranë është subjekt i legjitimuar në këtë gjykim kushtetues çështja e parë që kërkon përgjigje ka të bëjë me faktin nëse Bashkia Tiranë (kërkuari) është organ i qeverisjes vendore, i tillë, që të legjitimohet të iniciojë gjykimin kushtetues në kuptim të nenit 134/1/e të Kushtetutës.

3. Kushtetuta, në pjesën e gjashtë të titulluar “Qeverisja vendore”, ka përcaktuar organet e qeverisjes vendore, njësitë bazë të qeverisjes vendore, mënyrën e krijimit të tyre dhe kompetencat përkatëse. Në mënyrë të qartë dhe eksplicite Kushtetuta ka sanksionuar se organi *përfaqësues* i qeverisjes vendore është “këshilli” (neni 109/1) ndërsa *organi ekzekutiv* është “kryetari” (neni 109/2). Po kështu, në nenin 108/1 Kushtetuta ka parashikuar komunat, bashkitë dhe qarqet duke i përcaktuar ato si njësi bazë të qeverisjes vendore. Nga përmbajtja e normave të mësipërme rezulton se Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht organet e qeverisjes vendore duke mos lënë hapësirë për të interpretuar tej përmbajtjes së këtyre normave, apo për të përfshirë në rrethin e organeve të qeverisjes vendore edhe subjekte të cilat kanë një përcaktim të ndryshëm kushtetues, siç janë njësitë e qeverisjes vendore.

4. Sa më sipër mendoj se shumica, duke legjitimuar Bashkinë Tiranë ka lejuar që, një subjekt që nuk i përket kategorise së “organeve të qeverisjes vendore”, të iniciojnë një gjykim kushtetues, gjë që është në kundërshtim me kuptimin e nenit 134, paragrafi “1” germa “e” të Kushtetutës.

5. Kushtetuta, krahas përcaktimit të subjekteve që iniciojnë gjykimin kushtetues në mënyrë të pakushtëzuar (neni 134 paragrafi “1” nënparagrafi “a”, “b”, “c”, “ç”), në nenin 134 paragrafi “2” thekson se: “*Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “dh”, “e”, “ë” “f” dhe “g” të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre*”. Nga përmbajtja e kësaj norme rezulton se subjektet e specifikuar, në të cilat bëjnë pjesë dhe organet e qeverisjes vendore, mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesin e tyre. Në këtë vështrim, në funksion të legjitimitit *ratione materiae*, subjektet e përcaktuara si më sipër për të iniciuar një gjykim kushtetues kushtëzohen nga interesi i tyre. Në këto kushte, që kërkuari të legjitimohet ai duhet jo vetëm të jetë një nga organet e qeverisjes vendore, por duhet të plotësojë edhe kushtin tjetër, atë të interesit të ligjshëm/kushtetues. Organet e qeverisjes vendore kanë interes të ligjshëm për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur pretendojnë se kompetencat që u përcaktohen nga Kushtetuta u janë cenuar nga marrja apo dublimi i këtyre kompetencave, apo kur janë penguar për të ushtruar pushtetin.

6. Kompetencat/pushtetet e organeve të qeverisjes vendore dhe ato të njërive vendore janë të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë. Sipas nenit 108/3 të Kushtetutës, njërive vendore iu ngarkohet të kryejnë të gjitha *detyrat vetëqeverisëse*. Ndërsa, sipas nenit 108/4 të Kushtetutës, vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet (i) organeve të tyre përfaqësuese dhe (ii) referendumeve vendore. Nisur nga kompetencat me të cilat Kushtetuta pajis organet përfaqësuese dhe njësitë e qeverisjes vendore, vihet re një dallim i qartë midis tyre. Kështu, këshillat, me cilësinë e organit përfaqësues, Kushtetuta i ka pajisur me kompetencën për të ushtruar pushtetin vetëqeverisës, ndërsa njësitë vendore janë të ngarkuara për të zbatuar detyrat që burojnë nga pushteti vetëqeverisës i ushtruar nga këshillat, pushtet që konkretizohet në mënyrë të detajuar në nenin 113/1 të Kushtetutës.

7. Shumica ka legjitimuar Bashkinë Tiranë duke arsyetuar se ajo përfaqësohet nga Kryetari, i cili është organ ekzekutiv i pushtetit vendor. Është e vërtetë që organi ekzekutiv (Kryetari) nuk diferencohet nga personi juridik (bashkia), pasi ai njehsohet me të dhe përbën një të tërë, për faktin,

se shpreh vullnetin dhe vepron në përputhje me kompetencat që Kushtetuta dhe ligji i ka njohur Bashkisë, por është po kaq e vërtetë se këtu nuk përfshihen kompetencat të cilat Kushtetuta ia ka caktuar këshillit bashkiak. Edhe ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” përforcon qëndrimin që shpreh Kushtetuta se Kryetari i Bashkisë ushtron të gjitha kompetencat që ligji i ka njohur bashkisë. Shumica arsyeton se “*planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore*”, por nuk i konkretizon autoritetet vendore (njësi e qeverisjes vendore, organ përfaqësues, apo organ ekzekutiv) sipas kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta. Shumica, duke mos gjetur lidhjen që duhet të ekzistojë midis kërkuesit dhe interesit të tij kushtetues, bën një interpretim dhe referim në terma të përgjithshëm. Jo vetëm kaq, por shumica nuk merr parasysh nenin 113/3 të Kushtetutës që sanksionon se: “*Të drejtat për vetëqeverisje të njësive të qeverisjes vendore mbrohen në gjykatë*”. Kjo normë përcakton pa asnjë dyshim se, në rast ndërhyrje në kompetencat apo pushtetet e caktuara nga Kushtetuta, njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë t’i drejtohen juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe jo atij kushtetues.

8. Nisur nga rregullimi i mësipërm vlerësoj se Kushtetuta, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar njësitë e pushtetit vendor, organet e tyre, kompetencat, juridiksonin gjyqësor të zakonshëm në të cilat mbrohen të drejtat për vetëqeverisje të njësive të qeverisjes vendore dhe juridiksonin kushtetues në të cilin mbrohen interesat e organeve të qeverisjes vendore, nuk ka lënë hapësirë për interpretim të zgjeruar të rrethit të subjekteve që përfshihen në “*organet e qeverisjes vendore*”, sipas parashikimeve të nenit 134, pika 1, gërma “e” të saj.

9. Në përfundim të analizës së mësipërme vlerësoj se kërkuesi, Bashkia Tiranë, si njësi bazë e qeverisjes vendore, nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që përcakton neni 134 i Kushtetutës. Në këtë kuptim, kërkuesi Bashkia Tiranë nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues objekt shqyrtimi.

Anëtare: Vitore Tusha

NDREQJE GABIMI

Vendimi nr.09, datë 23.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese që i përket kërkesës së një Grupi Deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, Shoqatës Kombëtare të Prokurorëve, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me objekt: “a) Shpallja si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e ligjit nr.10 034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”; b) Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese”, që është publikuar në Fletoren Zyrtare nr.42, datë 16.4.2010, të korrigjohet si më poshtë:

Është:

Pika 38.6 Lustracioni nuk duhet të zbatohet për funksionet e zgjedhshme përveçse kur kjo gjë nuk kërkohet nga vetë kandidati-votuesit kanë të drejtë të zgjedhin këdo që ata dëshirojnë.

Bëhet:

Pika 38.6 Lustracioni nuk duhet të zbatohet për funksionet e zgjedhshme përveçse kur kjo gjë kërkohet nga vetë kandidati-votuesit kanë të drejtë të zgjedhin këto që ata dëshirojnë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.5.2010

Doli nga shtypi më 21.5.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 44 lekë